

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 27 numër 6 shtator 2025

Data e botimit: 18.9.2025

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.46, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin e brendshëm të funksionimit të sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS dhe sistemit AIPS Euro""	4
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.47, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin e brendshëm të funksionimit të sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH""	30
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.48, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e sistemit SWIFT në Bankën e Shqipërisë""	49
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.49, datë 3.9.2025 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro""	61
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.50, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin e ekspozitave të përkohshme të vlerave numizmatike dhe objekteve muzeore të Bankës së Shqipërisë, brenda dhe jashtë Bankës së Shqipërisë"	64
6. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 1, mars 2025	75
7. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 2, maj 2025	75
8. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 3, gusht 2025	76
9. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 4, shtator 2025	76
10. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 5, shtator 2025	76



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 46, datë 3.9.2025

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË
PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE – AIPS DHE SISTEMIT
AIPS EURO”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 4, shkronja “dh”, nenit 14, nenit 21 dhe nenit 43, shkronja “f”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 13 të ligjit nr. 133, datë 29.4.2013, “Për sistemin e pagesave”; nenit 129 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Titujve III dhe IV të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për organizimin e brendshëm të funksionimit të sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS dhe sistemit AIPS EURO”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Emisionit, Departamenti i Stabilitetit Financiar, Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme me zbatimin e këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 72, datë 22.12.2021, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e brendshëm të funksionimit të sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS dhe sistemit AIPS EURO””.

4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave të brendshme për administrimin, operimin dhe organizimin e sistemit AIPS për shlyerjen në Lekë dhe AIPS EURO për shlyerjen në Euro, nga Banka e Shqipërisë.
2. Subjekte të kësaj rregulloreje janë njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 2 Baza juridike

Për zbatimin e kësaj rregulloreje, njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë mbështeten në legjisllacionin e mëposhtëm:

- a) ligjin "Për Bankën e Shqipërisë";
- b) ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
- c) ligjin "Për sistemin e pagesave";
- d) ligjin "Për shërbimet e pagesave";
- e) ligjin "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë";
- f) rregulloren "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS";
- g) rregulloren "Për funksionimin e sistemit AIPS EURO për shlyerjen e transfertave vendase për klientë në Euro";
- h) aktet e tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë që lidhen, por nuk kufizohen me: funksionimin e sistemeve të pagesave, minimumin e rezervës së detyruar, instrumentet e pagesave elektronike, kredinë brenda ditës për bankat, kredinë njëditore për bankat, sigurinë e informacionit, administrimin e rrezikut operacional etj.

Neni 3 Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të rregullores, termat e përkufizuar në rregulloren "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS" dhe në rregulloren "Për funksionimin e sistemit AIPS EURO për shlyerjen e transfertave vendase për klientë në Euro", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore.
2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore, termat "sistem" dhe "sistemi AIPS" do të nënkuptojnë sistemin AIPS për shlyerjen në Lekë dhe AIPS EURO për shlyerjen në Euro si një i vetëm. Sistemi AIPS për shlyerjen në Lekë dhe sistemi AIPS EURO për shlyerjen në Euro janë teknikisht i njëjti sistem për sa i përket infrastrukturës dhe platformës së përdorur për aksesimin e shërbimeve nga përdoruesit,

- por nga pikëpamja e shërbimit të ofruar për përdoruesit e sistemit, rregullave të zbatueshme dhe pjesëmarrjes përkatësisht për secilin prej këtyre shërbimeve, përcaktohen si dy sisteme të veçanta.
3. Përveç sa parashikohet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të rregullores, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) **DE** – është Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë;
 - b) **DM** – është Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë;
 - c) **DNJ** – është Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë;
 - d) **DOM** – është Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë;
 - e) **DSF** – është Departamenti i Stabilitetit Financiar në Bankën e Shqipërisë;
 - f) **DSPKF** – është Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës në Bankën e Shqipërisë, i cili në cilësinë e përgjegjësit të sistemit, përcakton kriteret për trajtimin, administrimin dhe aksesimin e sistemit, si dhe pranon dhe miraton ndryshimet apo përmirësimet e mundshme në lidhje me funksionet operacionale të sistemit;
 - g) **DTI** – është Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në Bankën e Shqipërisë, i cili në cilësinë e kujdestarit të sistemit kujdeset për sistemin, duke administruar teknikisht atë dhe infrastrukturën mbështetëse të tij, si dhe duke zbatuar dhe mbrojtur rregullat e përcaktuara nga përgjegjësi i sistemit;
 - h) **Ministria** – është ministria përgjegjëse për financat;
 - i) **Rregullorja për sistemin AIPS** – është rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS” dhe çdo ndryshim i saj;
 - j) **Rregullorja për sistemin AIPS EURO** – është rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Për funksionimin e sistemit AIPS EURO për shlyerjen e transfertave vendase për klientë në Euro” dhe çdo ndryshim i saj;
 - k) **Shtojca** – janë dokumentet A dhe B që i bashkëlidhen kësaj rregulloreje dhe janë pjesë përbërëse e saj.

KREU II FUNKSIONET E DEPARTAMENTEVE NË SISTEMIN AIPS

Neni 4 Funksionet e DSPKF-së

DSPKF-ja në sistemin AIPS ushtron funksionet e mëposhtme:

1. Është përgjegjës i sistemit AIPS;
2. Administron operacionalisht sistemin AIPS;
3. Zbaton politikën e sigurisë në sistemin AIPS, në cilësinë e përgjegjësit të sistemit;
4. Faturon detyrimet e pjesëmarrësve për shërbimet e sistemit AIPS të ofruara nga Banka e Shqipërisë, duke bërë regjistrimet përkatëse

- në sistemet e vendosura në dispozicion nga autoritetet përgjegjëse. Ekzekuton dhe ndjek shlyerjen e pagesave të tyre në sistemin AIPS;
5. Kur është e nevojshme, kryen ndryshimin e orareve të operimit të sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë, dhe/ose të sistemit AIPS EURO, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi;
 6. Kryen procedurat për kufizimin e përkohshëm, dhe/ose përjashtimin e pjesëmarrësit në sistem, si dhe njofton për këtë pjesëmarrësit;
 7. Përfaqëson Bankën e Shqipërisë si agjent shlyerës, duke ekzekutuar në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë instruksionet për shlyerje neto, si dhe urdhërpagesat e pjesëmarrësve të tërthortë në atë sistem;
 8. Përfaqëson Bankën e Shqipërisë si pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe sistemin AIPS EURO, duke pasqyruar, procesuar dhe monitoruar transaksionet e regjistruara për qëllime të aktivitetit të saj;
 9. Kryen veprimet e nevojshme për shtimin ose pakësimin e fondeve në llogarinë e pjesëmarrësit në sistemin AIPS EURO sipas urdhrave përkatëse të dërguara nga pjesëmarrësi, në përputhje me rregullat e sistemit AIPS EURO. Në raste të nevojave për stornim të një veprimi të gabuar, njofton pjesëmarrësin;
 10. Ndjek/monitoron shlyerjen në sistemin AIPS të instruksioneve të pagesave të transferuara nga sisteme vartëse;
 11. Në raste të pamundësive teknike për transferimin e instruksioneve të pagesave nga sistemet vartëse të operuara nga Banka e Shqipërisë për në sistemin AIPS, kryen regjistrimin e tyre në sistemin AIPS bazuar në dokumentacionin përkatës të dërguar me e-mail dhe/ose shkresë zyrtare të departamentit iniciues, siç përcaktohet në këtë rregullore;
 12. Në raste të pamundësive teknike për regjistrimin e instruksioneve të pagesave nga departamentet përgjegjëse për ato instruksione në sistemin AIPS, kryen regjistrimin e tyre në sistemin AIPS bazuar në dokumentacionin përkatës të dërguar me shkresë zyrtare të departamentit iniciues, siç përcaktohet në këtë rregullore;
 13. Për pjesëmarrës operatorë në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, me përjashtim të operatorëve të skemave ndërkombëtare të pagesave me kartë, në raste të ngjarjeve të paparashikuara, dhe sipas shkresës zyrtare të pjesëmarrësit të nënshkruar nga nënshkrimet e autorizuara sipas rregullit dhe klasifikimit të njoftuara zyrtarisht nga pjesëmarrësi, kryen regjistrimin e instruksioneve të shlyerjes neto përkatëse;
 14. Për pjesëmarrës operatorë të skemave ndërkombëtare të pagesave me kartë në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, vepron në përputhje me përcaktimet në marrëveshjet e posaçme të lidhura me ta, për kryerjen e veprimeve të mëposhtme:
 - a) në raste të ngjarjeve të paparashikuara ose pamundësisë për të vepruar të pjesëmarrësit operator, dhe sipas kërkesës/udhëzimit të komunikuar nga pjesëmarrësi, regjistron në sistem instruksionet e shlyerjes neto të dërguara nga pjesëmarrësi operator në komunikimin përkatës,
 - b) në raste të ngjarjeve të paparashikuara ose pamundësisë për të vepruar të pjesëmarrësit operator, dhe sipas kërkesës/udhëzimit të komunikuar nga pjesëmarrësi, kryen anulimin e instruksioneve në

- gjendje pezull të dërguara nga ai pjesëmarrës në sistem,
- c) kryen korrigjimet e nevojshme në rast të regjistrimit të gabuar të një instruksioni, duke njoftuar sipas rastit pjesëmarrësit e ndikuar;
 15. Për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, pas kërkesës me shkresë zyrtare të pjesëmarrësit, të nënshkruar nga nënshkrimet e autorizuara sipas rregullit dhe klasifikimit të njoftuara zyrtarisht nga pjesëmarrësi, ose urdhër të dërguar me mesazh SWIFT të autentifikuar, në raste të lidhura me mosfunksionime në infrastrukturë, apo për arsye të përfundimit të afateve kohore sipas orareve të operimit të sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë në lidhje me procesimin e transaksioneve, kryen regjistrimin e transaksioneve ndërbankare të pjesëmarrësit;
 16. Kryen ndryshimin e radhitjes së urdhërpagesave me kërkesë të pjesëmarrësve ose kur e çmon të domosdoshme, për qëllime të efektivitetit në operimin e sistemit dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi;
 17. Ndërhyn për anulimin e një urdhërpagese të pashlyer në radhë, nëse kjo gjë kërkohet nga pjesëmarrësi, ose kur lind e nevojshme dhe çmon se pjesëmarrësi, për shkak të problemeve teknike, nuk mund ta administrojë radhën përkatëse;
 18. Ndërhyn për anulimin e transaksionit të mbetur në gjendje pezull për çështje përputhshmërie me listën e sanksioneve, në rastin kur pjesëmarrësi nuk është në gjendje të kryejë vetë anulimin e transaksionit të tij, dhe/ose ky transaksion pengon ecurinë normale të operimit të sistemit AIPS;
 19. Përgatit dhe publikon statistika mbi veprimtarinë në sistemin AIPS;
 20. Bashkëpunon me departamentet e tjera në lidhje me zbatimin e rregulloreve të sistemit AIPS;
 21. Mban dhe përditëson listën e personave të kontaktit të çdo pjesëmarrësi për sistemin AIPS, si dhe njofton pjesëmarrësit për listën e përditësuar të personave të kontaktit të Bankës së Shqipërisë për sistemin AIPS;
 22. Mban dhe përditëson listën e nënshkrimeve të autorizuara (të shoqëruar me kategoritë dhe limitet përkatëse) të pjesëmarrësve, që përdoren për sistemin AIPS;
 23. Për çdo shkresë zyrtare, formular apo raport që adresohet në Bankën e Shqipërisë në lidhje me sistemin AIPS, kryen verifikimin e nënshkrimeve të autorizuara aty ku është e aplikueshme, përpara se të kryhen veprime të mëtejshme nga njësitë e tjera apo vetë DSPKF-ja. Pas verifikimit me sukses të nënshkrimeve të autorizuara, përcjell shkresën e mbërritur me korrespondencë zyrtare për në njësinë përgjegjëse të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e veprimeve të mëtejshme;
 24. I dërgon shkresë zyrtare pjesëmarrësit për çdo rast të shkeljes së detyrimeve të pjesëmarrësit në sistemin AIPS;
 25. Informon DM-në për çdo rast të evidentuar të shkeljeve të detyrimeve të pjesëmarrësve në sistemin AIPS, sipas akteve nënligjore në fuqi;
 26. Informon në çdo rast me shkresë zyrtare DM-në mbi transaksionet e filtruara në sistemin AIPS sipas listës së sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;

27. Informon dhe bashkëpunon me DOM-in, DM-në, DSF-në dhe DNJ-në për raste ku pjesëmarrësit në sistemin AIPS paraqesin problematika në sistemin e pagesave, me ndikim në sistemin bankar apo financiar në tërësi;
28. Bashkëpunon dhe shkëmben informacione me DOM-in, DM-në, DSF-në, DNJ-në dhe DTI-në për krijimin e mjeteve dhe procedurave në kuadër të ruajtjes së sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të pagesave;
29. Informon dhe bashkëpunon me njësinë përgjegjëse për mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve të pagesave, për raste kur pjesëmarrës operatorë në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë paraqesin problematika me ndikim në infrastrukturën e tregut financiar;
30. Raporton pranë njësisë përgjegjëse për administrimin e rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë, mbi ngjarjet e rrezikut operacional të lidhura me sistemin AIPS në këndvështrimin operacional.

Neni 5 Funksionet e DTI-së

DTI-ja në sistemin AIPS ushtron funksionet e mëposhtme:

1. Është kujdestar i sistemit AIPS;
2. Administron dhe mirëmban teknikisht sistemin AIPS dhe infrastrukturën mbështetëse të tij, përfshirë shërbimet përkatëse të SWIFT në funksion të sistemit AIPS;
3. Zbaton politikën e sigurisë në sistemin AIPS në cilësinë e kujdestarit të sistemit dhe ndërton mekanizma të sigurt për:
 - i. mbrojtjen e aksesit ndaj tij,
 - ii. autentifikimin e dërguesit të instruksionit të pagesës,
 - iii. mbrojtjen e besueshmërisë dhe të konfidencialitetit të informacionit të marrë dhe të ruajtur nga sistemi AIPS.
4. Shqyrton kërkesat nga përdoruesit për zhvillime të reja në sistemin AIPS dhe pas vlerësimit të mundësive të realizimit, ndërmer hapat e nevojshëm sipas rasteve, në bashkëpunim me DSPKF-në, për implementimin e tyre në sistem;
5. Ndërton mekanizma për evidentimin e incidenteve dhe problemeve lidhur me funksionimin e sistemit AIPS dhe infrastrukturës që e mbështet;
6. Mban regjistrin e anomalive/problematikave të identifikuar ose të sinjalizuara në lidhje me sistemin AIPS, si dhe merr masa për zgjidhjen e tyre. Në rast se zgjidhja e anomalisë është jashtë mundësive teknike dhe kompetencave të DTI-së, atëherë DTI-ja njofton kompaninë kontraktore që ka ofruar sistemin AIPS dhe shërbimin e mirëmbajtjes së tij, për të asistuar në zgjidhjen e saj;
7. Zbaton në sistem procedurat për vendosjen e versioneve të reja, si dhe kryen përditësimet në përputhje me instruksionet e dhëna nga kompania kontraktore që ka ofruar sistemin AIPS;
8. Administron teknikisht përdoruesit dhe të drejtat në sistem;
9. Administron formularët/kërkesat për përdorues dhe ndryshime në

- VPN, pajisje sigurie, certifikata digjitale dhe përdorues të lidhur me sistemin AIPS, të paraqitura nga DSPKF-ja si përgjegjës i sistemit;
10. Harton dhe zbaton procedurat *Fallback-Recovery* dhe *Backup-Restore* në funksion të vazhdimësisë së veprimtarisë, i teston periodikisht ato, si dhe informon DSPKF-në mbi rezultatet;
 11. Shqyrton njoftimin e pjesëmarrësit për raste kur ai pjesëmarrës raporton për testime ose ndryshime infrastrukturore, të cilat mund të ndikojnë aftësinë e tij për të operuar në sistemin AIPS dhe e udhëzon atë sipas rastit;
 12. Informon DSPKF-në për çdo rast të evidentuar shkeljeje të detyrimeve teknike të pjesëmarrësve në sistemin AIPS, me qëllim që DSPKF-ja të vijojë me njoftimin e DM-së sipas akteve nënligjore në fuqi;
 13. Bashkëpunon dhe shkëmben informacione me DSPKF-në, DOM-in, DM-në, DSF-në dhe DNJ-në për krijimin e mjeteve dhe procedurave në kuadër të ruajtjes së sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të pagesave;
 14. Raporton pranë njësisë përgjegjëse për administrimin e rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë, mbi ngjarjet e rrezikut operacional të lidhura me sistemin AIPS në këndvështrimin teknik.

Neni 6

Funksione të përbashkëta mes DSPKF-ja dhe DTI-ja

DSPKF-ja dhe DTI-ja në sistemin AIPS ushtrojnë funksione të përbashkëta si më poshtë:

1. Zbatojnë rregullat për sigurinë e informacionit në funksion të garantimit të parimeve të sigurisë: disponueshmërisë, konfidencialitetit, integritetit, aksesit të kontrolluar në sistem;
2. Ndjekin procedurat për anëtarësimin e pjesëmarrësve të rinj në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe në sistemin AIPS EURO;
3. Ndjekin procedurat për administrimin e AIPS CUG dhe shërbimit përkatës të SWIFT;
4. Mbajnë kontaktet dhe mbështesin pjesëmarrësit në operimin në sistemin AIPS, përkatësisht DSPKF-ja për çështjet operationale dhe DTI-ja për çështjet teknike e infrastrukturore;
5. Administrojnë ngjarjet e paparashikuara dhe situatat e emergjencës në sistemin AIPS, si dhe mbajnë kontakt me pjesëmarrësit për t'i informuar dhe asistuar ata në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore;
6. Janë pikë kontakti me kompaninë kontraktore që ka ofruar sistemin AIPS dhe ofron shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit AIPS, si dhe ndjekin zbatimin e kontratave me të;
7. Shqyrtojnë raportimet e pjesëmarrësve të sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë dhe të sistemit AIPS EURO, në lidhje me ngjarjet e paparashikuara të regjistruara pranë pjesëmarrësit dhe ecurinë e tyre deri në zgjidhje, raportet e incidentit, si dhe raportin e vetëvlerësimit të pjesëmarrësit për operimin në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe në sistemin AIPS EURO. Nëse DTI-ja konstaton

- elemente teknike, të cilat mund të kenë ndikim në operacionet në sistemin AIPS ose në aftësinë e pjesëmarrësit për të operuar në sistemin AIPS, ia vë në vëmendje ato DSPKF-së;
8. Bashkëpunojnë gjatë proceseve të testimeve në sistemin AIPS në mjedisin e dedikuar për këtë qëllim;
 9. Bashkëpunojnë për ndjekjen, koordinimin dhe monitorimin e testimeve që kryhen në sistem nga subjekte në proces licencimi si subjekte bankare dhe që kanë lidhur marrëveshje për të kryer testime paraprake në mjedisin test të sistemit AIPS;
 10. Bashkëpunojnë për përcaktimin e matricës së korrespondencës së funksionaliteteve të sistemit AIPS që i përkasin roleve për të drejtat e përdoruesve në sistemin AIPS;
 11. Bashkëpunojnë gjatë procesit të testimit të procedurave *Fallback-Recovery*;
 12. Bashkëpunojnë për hartimin e raporteve mbi incidente apo ngjarje të paparashikuara në infrastrukturën pranë Bankës së Shqipërisë, që ndikojnë në disponueshmërinë e shërbimit të sistemit AIPS për pjesëmarrësit;
 13. Raportojnë në përputhje me aktet e miratuara në fuqi në lidhje me mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë, pranë njësisë përgjegjëse në Bankën e Shqipërisë që kryen këtë funksion;
 14. Bashkëpunojnë për formulimin e njoftimeve për pjesëmarrësit në rastet e ngjarjeve të paparashikuara, situatave të emergjencës, apo aplikimit të ndryshimeve në sistem, kur këto ndryshime kanë ndikim në veprimtarinë operacionale të pjesëmarrësve. Nëse shihet e nevojshme të jepen instruksione të mëtejshme, ato dërgohen përkatësisht nga DSPKF-ja për detajet operacionale dhe nga DTI-ja për detajet teknike e infrastrukture;
 15. Në rastet kur kërkohet zyrtarisht nga një pjesëmarrës informacion mbi të dhëna të arkivuara dhe të paaksesueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në sistemin AIPS, DTI-ja siguron informacionin e kërkuar në një format të përshtatshëm, dhe DSPKF-ja harton raportin informues për pjesëmarrësin brenda afatit të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi;
 16. Kryejnë procedurën e përditësimit dhe importimit të listës së sanksioneve të publikuar në formatin elektronik nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;
 17. Hartojnë akte nënligjore të nevojshme për mirëfunksionimin dhe sigurinë e sistemit.

Neni 7 Funksionet e DOM-it

DOM-i, në lidhje me sistemin AIPS, ushtron funksionet e mëposhtme:

1. Informohet mbi gjendjen e likuiditetit nëpërmjet sistemit AIPS;
2. Inicion dhe transferon veprime për qëllime të aktivitetit operacional të DOM-it nëpërmjet sistemeve vartëse, shlyerja e *cash* e të cilave realizohet në sistemin AIPS;

3. Përcakton rezervat e detyruara për pjesëmarrësit e sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë dhe kryen regjistrimin e tyre në sistem;
4. Përcakton normat e remunerimit dhe të gjobave në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe kryen regjistrimin e tyre në sistemin AIPS;
5. Për çdo ndryshim në rregulloren e Rezervës së detyruar, si dhe të normës së remunerimit, njofton me shkrim DSPKF-në;
6. Bashkëpunon me DSPKF-në në funksion të realizimit të shlyerjes së veprimeve të iniciuara nga DOM-i, si dhe në rrethana të paparashikuara kur lind nevoja, kërkon ndryshimin e orareve të operimit të sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, deri në finalizimin e shlyerjes;
7. Njofton DSPKF-në në raste kur ka evidencë se një subjekt pjesëmarrës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë paraqet vështirësi financiare, apo është vendosur në një status të caktuar me ndikim në sistemin e pagesave, si dhe kur evidentohen zhvillime në sektorin bankar me ndikim në sistemin e pagesave. Në situata të tilla, aty ku është e aplikueshme, bashkëpunon ngushtësisht me DM-në, DSF-në, DNJ-në dhe DSPKF-në;
8. Bashkëpunon dhe shkëmben informacione me DSPKF-në, DM-në, DSF-në, DNJ-në dhe DTI-në për krijimin e mjeteve dhe procedurave në kuadër të ruajtjes së sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të pagesave.

Neni 8 Funksionet e DE-në

DE-ja, në lidhje me sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, ushtron funksionet e mëposhtme:

1. Inicion dhe transferon veprime për qëllime të aktivitetit operacional të DE-së nëpërmjet sistemeve vartëse, shlyerja e *cash* e të cilave realizohet në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë;
2. Përdor mjetet që ka në dispozicion për t'u informuar mbi statusin e shlyerjes në sistemin AIPS të transaksioneve të iniciuara prej tij;
3. Kryen rakordimin ditor me DSPKF-në për veprimet e iniciuara nga DE-ja në sistemet vartëse dhe të shlyera në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, dhe komunikojnë konfirmimet me e-mail;
4. Bashkëpunon me DSPKF-në në funksion të realizimit të shlyerjes së veprimeve të iniciuara nga DE-ja, si dhe në rrethana të paparashikuara kur lind nevoja, kërkon ndryshimin e orareve të operimit të sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, deri në finalizimin e shlyerjes.

Neni 9 Funksionet e DM-së

DM-ja, në lidhje me sistemin AIPS, ushtron funksionet e mëposhtme:

1. Nëse gjatë proceseve të inspektimit të ushtruara nga DM-ja të subjektet pjesëmarrëse në sistemin AIPS dhe që mbikëqyren nga DM-ja, verifikohet se komisionet bankare të aplikuar nga këto

- subjekte ndaj klientëve të tyre për urdhërpagesa në nisje dhe në mbërritje në sistemin AIPS, janë mbi kufijtë e përcaktuar në rregullat e funksionimit të sistemit AIPS, atëherë DM-ja njofton me shkresë zyrtare DSPKF-në për rastin e verifikuar të shkeljes së rregullores për sistemin AIPS ose rregullores për sistemin AIPS EURO;
2. Në përfundim të inspektimit të plotë ose të pjesshëm, të kryer nga ana e DM-së pranë subjekteve bankare, i përcjell DSPKF-së rezultatet e inspektimit në lidhje me sistemet e pagesave që operohen nga Banka e Shqipërisë. Përcjellja e rezultateve mund të bëhet me shkresë zyrtare ose në format elektronik nga/për punonjësit e përcaktuar nga Drejtuesi i njësisë përkatëse;
 3. Njofton pa vonesë DSPKF-në, në raste kur nga DM-ja evidentohet se një subjekt pjesëmarrës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë paraqet vështirësi financiare, apo është vendosur në një status të caktuar me ndikim në sistemin e pagesave, është në proces likuidimi/falimentimi, si dhe kur evidentohen zhvillime në sektorin bankar me ndikim në sistemin e pagesave. Në situata të tilla, aty ku është e aplikueshme, bashkëpunon ngushtësisht me DOM-in, DSF-në, DNJ-në dhe DSPKF-në;
 4. Njofton pa vonesë DSPKF-në në çdo rast kur nis një proces bashkimi/përthithjeje e një banke me/nga një/disa bankë/a në një të vetme, në çdo rast kur nis një vendosje në proces likuidimi/falimentimi, si dhe kur nis një proces pezullimi apo revokimi (shfuqizimi) i licencës së një subjekti, i cili mbikëqyret nga DM-ja dhe është pjesëmarrës në sistemet e pagesave;
 5. Bashkëpunon dhe shkëmben informacione me DSPKF-në, DOM-in, DSF-në, DNJ-në dhe DTI-në për krijimin e mjeteve dhe procedurave në kuadër të ruajtjes së sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të pagesave;
 6. Në çdo rast kur njoftohet nga DSPKF-ja mbi transaksione të filtruara në sistemin AIPS sipas listës së sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, kryen njoftimin e nevojshëm pranë autoriteteve kompetente dhe ndjek rastin në rolin e autoritetit mbikëqyrës.

Neni 10 Funksionet e DNJ-së

DNJ-ja, në lidhje me sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, ushtron funksionet e mëposhtme:

1. Në rast të konstatimit se për një bankë pjesëmarrëse në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, janë plotësuar kushtet për vendosjen në ndërhyrje të jashtëzakonshme, komunikon këtë konstatim pa vonesë pranë DSPKF-së;
2. Gjatë zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për një bankë pjesëmarrëse, sigurohet që të ruhet aksesimi i kësaj të fundit në sistemet e pagesave, duke bashkëpunuar me DSPKF-në për masat që duhet të ndërmerren;
3. Në kuadër të rasteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për një bankë pjesëmarrëse në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, bashkëpunon

- ngushtësisht me DSPKF-në dhe DOM-in;
4. Bashkëpunon dhe shkëmben informacione me DSPKF-në, DOM-in, DSF-në, DM-në dhe DTI-në për krijimin e mjeteve dhe procedurave në kuadër të ruajtjes së sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të pagesave.

Neni 11 **Funksionet e DSF-së**

DSF-ja, në lidhje me sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, ushtron funksionet e mëposhtme:

1. Njofton DSPKF-në në raste kur ka evidencë se një subjekt pjesëmarrës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë paraqet vështirësi financiare, apo është vendosur në një status të caktuar me ndikim në sistemin e pagesave, si dhe kur evidentohen zhvillime në sektorin bankar me ndikim në sistemin e pagesave. Në situata të tilla, aty ku është e aplikueshme, bashkëpunon ngushtësisht me DOM-in, DM-në, DNJ-në dhe DSPKF-në;
2. Bashkëpunon dhe shkëmben informacione me DSPKF-në, DOM-in, DM-në, DNJ-në dhe DTI-në për krijimin e mjeteve dhe procedurave në kuadër të ruajtjes së sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të pagesave.

KREU III **PJESËMARRJA NË SISTEMIN AIPS**

Neni 12 **Procedurat e anëtarësimit**

Procedurat e anëtarësimit si pjesëmarrës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe në sistemin AIPS EURO ndiqen nga DSPKF-ja dhe DTI-ja, në bashkëpunim me kandidatin për pjesëmarrës, si dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Këto procedura kalojnë në hapat e mëposhtëm:

1. DSPKF-ja merr në shqyrtim kërkesën zyrtare të kandidatit për anëtarësim në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO, dhe informon kandidatin për miratimin ose jo të kërkesës së tij. Nëse kërkesa e kandidatit miratohet, atëherë vijohet me hapat e tjerë;
2. Informimi dhe asistenca teknike për kandidatin në procesin e anëtarësimit
 - a) DSPKF-ja informon kandidatin mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin me anëtarësimin e tij si pjesëmarrës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO, duke i vënë në dispozicion aktet nënligjore në fuqi lidhur me sistemin AIPS, si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm,
 - b) DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë për hartimin, rast pas rasti, të kalendarit të detajuar me hapat teknikë të anëtarësimit dhe DSPKF-ja ia komunikon atë kandidatit,

- c) DTI-ja informon kandidatin mbi infrastrukturën teknike që duhet të ketë në dispozicion dhe për detaje të tjera të lidhura me parametrat dhe kushtet teknike që infrastruktura duhet të plotësojë, si dhe e asiston teknikisht atë,
 - d) DTI-ja vë në dispozicion të kandidatit mjetet e duhura, aty ku është e aplikueshme, si dhe dokumentacionin teknik të nevojshëm për kryerjen e instalimeve dhe implementimin e infrastrukturës së duhur për operimin e kandidatit në sistemin AIPS,
 - e) DTI-ja dhe DSPKF-ja udhëzojnë dhe ndjekin procesin e anëtarësimit të kandidatit në AIPS CUG dhe shërbimin përkatës të SWIFT;
3. Testimi dhe trajnimi i kandidatit
- a) DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë për trajnimin e përdoruesve të ardhshëm të kandidatit për funksionet e sistemit AIPS,
 - b) DTI-ja dhe DSPKF-ja, në bashkëpunim me kandidatin, kryejnë testimet e nevojshme në sistemin AIPS,
 - c) DTI-ja, në bashkëpunim me kandidatin, kryen testime për elementet teknike të infrastrukturës që do të mbështesë operimin e kandidatit në sistemin AIPS;
4. Aksesimi i sistemit TEST
- a) DTI-ja pajis kandidatin me certifikatat dhe pajisjet e sigurisë, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AIPS,
 - b) DTI-ja krijon përdoruesit e kandidatit në VPN, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AIPS,
 - c) DTI-ja krijon dy oficerët e sigurisë së kandidatit në sistemin TEST, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AIPS;
5. Përgatitja e dokumentacionit
- a) DSPKF-ja dhe DTI-ja këshillojnë kandidatin gjatë procesit të hartimit të dokumentacionit dhe bazës rregullative mbi:
 - i. operimin në sistemin AIPS,
 - ii. sigurinë e transmetimit të informacionit/instrukcioneve nga sistemet e tij për në sistemin AIPS,
 - iii. planet e emergjencës;
6. Pranimi në anëtarësim
- a) DTI-ja dhe DSPKF-ja shqyrtojnë plotësimin e dokumentacionit dhe bazës rregullative, si dhe plotësimin e të gjitha kushteve për pjesëmarrje në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO nga ana e kandidatit, dhe nëse e vlerësojnë të plotë dokumentacionin dhe vlerësojnë se kandidati i plotëson të gjitha kushtet, vijojnë me hapat e tjerë,
 - b) DSPKF-ja ruan dokumentacionin e anëtarësimit të kandidatit përfshirë marrëveshjen e pjesëmarrjes së kandidatit (aty ku aplikohet);
7. Aktivizimi i pjesëmarrësit
- a) DSPKF-ja krijon pjesëmarrësin në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, si dhe pjesëmarrësin në sistemin AIPS EURO, pas nënshkrimit të marrëveshjes tip të pjesëmarrjes, aty ku aplikohet,
 - b) DSPKF-ja njofton pjesëmarrësit e tjerë për anëtarësimin e pjesëmarrësit të ri 5 (pesë) ditë pune përpara datës në të cilën ky pjesëmarrës fillon veprimtarinë *live* në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose në sistemin AIPS EURO,

- c) DTI-ja pajis pjesëmarrësin me certifikatat dhe pajisjet e sigurisë, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AIPS,
- d) DTI-ja krijon përdoruesit e pjesëmarrësit në VPN, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AIPS,
- e) DTI-ja krijon dy oficerët e sigurisë së pjesëmarrësit në sistemin *LIVE*, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AIPS.

Neni 13 Kufizimi i përkohshëm dhe përjashtimi

Kufizimi i përkohshëm apo përjashtimi i një pjesëmarrësi në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO kryhet nga DSPKF-ja pasi është konsultuar më parë me DOM-in, DM-në, DSF-në e DNJ-në sipas rastit, dhe miratohet nga Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë.

KREU IV ADMINISTRIMI I SISTEMIT AIPS

Neni 14 Administrimi i pjesëmarrësit

Në drejtim të administrimit të pjesëmarrësit në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe sistemin AIPS EURO, DSPKF-ja kryen funksionet e mëposhtme:

1. Krijon pjesëmarrësin në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose pjesëmarrësin në sistemin AIPS EURO dhe kryen njoftimet përkatëse, siç është përcaktuar në procedurat e anëtarësimit;
2. Krijon dhe administron llogaritë në sistemin AIPS;
3. Me kërkesë/njoftim të pjesëmarrësit, modifikon/përditëson detaje të pjesëmarrësit, si adresa, personat e kontaktit etj.;
4. Bazuar në vendime për ndryshime në lidhje me subjektin pjesëmarrës, kryen modifikimin/përditësimin e pjesëmarrësit dhe/ose llogarive të shlyerjes së pjesëmarrësit në sistemin AIPS;
5. Kufizon përkohësisht aksesin e pjesëmarrësit në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO dhe/ose përjashton pjesëmarrësin nga sistemi AIPS i shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemi AIPS EURO, si dhe kryen njoftimet përkatëse në përputhje me aktet nënligjore në fuqi;
6. Në rastin e kufizimit të përkohshëm apo të përjashtimit të një pjesëmarrësi nga sistemi AIPS, diskuton paraprakisht dhe koordinon me DOM-in e DM-në, në raste të lidhura me ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit të pagesave edhe me DSF-në, si dhe në rastin e plotësimit të kushteve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme edhe me DNJ-në, për procedurat që do të ndiqen;
7. Në raste të përjashtimit të një pjesëmarrësi nga sistemi AIPS:
 - a) Për përjashtimin e pjesëmarrësit nga sistemi AIPS i shlyerjes në Lekë, njofton me shkresë zyrtare DM-në, DOM-in dhe DE-në për ekzekutimin e mbylljes së llogarive të shlyerjes së pjesëmarrësit,

- b) Për përjashtimin e pjesëmarrësit nga sistemi AIPS EURO, njofton me shkresë zyrtare DM-në dhe DOM-in për ekzekutimin e mbylljes së llogarive të shlyerjes së pjesëmarrësit,
- c) njofton me shkresë zyrtare DTI-në për të kryer sipas rastiit fshirjen/ bllokimin e përdoruesve të pjesëmarrësit nga sistemi AIPS, si dhe aty ku është e aplikueshme, DSPKF-ja, në bashkëpunim me DTI-në, marrin masat e nevojshme në lidhje me AIPS CUG dhe shërbimin përkatës të SWIFT për këtë pjesëmarrës.

Neni 15 Administrimi i përdoruesve

1. DSPKF-ja, në cilësinë e përgjegjës të sistemit AIPS, dhe DTI-ja, në cilësinë e kujdestarit të sistemit AIPS, në bashkëpunim, përcaktojnë matricën e korrespondencës së funksionaliteteve të sistemit AIPS, që i përkasin roleve për të drejtat e përdoruesve bazuar në aktivitetin operacional që duhet të kryejnë, duke pasur në vëmendje parimet bazë të "katër syve" dhe të të drejtave minimale në sistemin AIPS.
2. DTI-ja, në cilësinë e kujdestarit të sistemit, realizon veprimet e mëposhtme në lidhje me administrimin e përdoruesve të sistemit AIPS:
 - a) krijon teknikisht rolet për të drejtat e përdoruesve në sistemin AIPS, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni;
 - b) krijon përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në sistemin AIPS test, pas miratimit me e-mail të drejtuesit të DSPKF-së;
 - c) krijon, modifikon ose fshin përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në sistemin AIPS primar, sipas kërkesës së nënshkruar nga drejtuesi i Departamentit kërkues, dhe të miratuar nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së, sipas Shtojcës A bashkëlidhur;
 - d) administron certifikatat digjitale për përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në lidhje me sistemin AIPS, sipas kërkesës së nënshkruar nga drejtuesi i Departamentit kërkues, dhe të miratuar nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së, sipas Shtojcës B bashkëlidhur;
 - e) bazuar në aktet nënligjore në fuqi, për përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në sistemin AIPS, modifikon statusin e llogarisë së përdoruesit dhe/ose rivendos fjalëkalimin e tij, në përputhje me kërkesën për ndryshim në llogarinë e përdoruesit nga drejtuesi i Departamentit përkatës, si dhe zotëruesi i llogarisë, në rastin e rivendosjes së fjalëkalimit;
 - f) krijon, modifikon ose fshin përdorues të një pjesëmarrësi, si dhe rivendos fjalëkalim të përdoruesit të pjesëmarrësit, në rast pamundësie të kryerjes së kësaj procedure nga vetë pjesëmarrësi, sipas përcaktimeve në rregulloren për sistemin AIPS dhe rregulloren për sistemin AIPS EURO;
 - g) rinovon çdo vit certifikatat digjitale të përdoruesve të pjesëmarrësve në sistemin AIPS, të paraqitura prej tyre në Bankën e Shqipërisë në përfundim të afatit të skadencës, sipas përcaktimeve në rregulloren për sistemin AIPS dhe rregulloren për sistemin AIPS EURO.

Neni 16 Administrimi i kalendarit

Në bazë të njoftimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë mbi kalendarin e festave zyrtare, DSPKF-ja:

- a) plotëson kalendarin për vitin pasardhës, para fillimit të vitit të ri ushtrimor;
- b) ndryshon kalendarin dhe njofton pjesëmarrësit, në çdo rast ndryshimi të planifikuar, kur është e mundur jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune përpara datës së kryerjes së këtyre ndryshimeve.

Neni 17 Administrimi i orareve të operimit

1. DSPKF-ja ndryshon oraret e operimit në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë ose në sistemin AIPS EURO, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe pasi vlerëson rrethanat në të cilat lind nevoja për ndryshim të orareve, duke përfshirë këtu:
 - a) ngjarje të paparashikuara dhe situata emergjence;
 - b) kërkesë nga një njësi e Bankës së Shqipërisë;
 - c) kërkesë nga një pjesëmarrës.
2. Pjesëmarrësit e sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë dhe pjesëmarrësit e sistemit AIPS EURO lajmërohen për ndryshimin e orareve nëpërmjet njoftimeve automatike të sistemit ose nga DSPKF-ja me e-mail ose mesazh SWIFT.

Neni 18 Testimi dhe ndryshimet në sistem

1. Çdo kërkesë për ndryshim në sistemin AIPS vlerësohet nga DSPKF-ja dhe DTI-ja përkatësisht në cilësinë e përgjegjësimit të sistemit dhe kujdestarit të sistemit, dhe miratohet prej tyre për t'u zbatuar kur çmohet e arsyeshme.
2. Në rastet kur ndryshimet e propozuara kanë ndikime të pjesëmarrësit e tjerë të sistemit AIPS, DSPKF-ja dhe DTI-ja këshillohen paraprakisht me këta të fundit.
3. DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë në kryerjen e testeve në raste kur lind nevoja të shqyrtohen sjellje funksionale të sistemit, ndërveprime të tij me sisteme të tjera, përditësime të ofruara nga kompania kontraktore që kryen mirëmbajtjen e sistemit AIPS, si dhe kur evidentohen problematika në funksionim.
4. Çdo ndryshim duhet të aplikohet në sistemin AIPS vetëm pasi të jetë testuar në mjedisin e dedikuar për testim, dhe pas miratimit nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së. DTI-ja kujdeset që aplikimi i ndryshimeve në sistemin AIPS, të kryhet në të dy mjediset, primar dhe *backup*.
5. Në lidhje me ndryshime të rëndësishme, të cilat prekin aspekte të caktuara të sistemit AIPS, siç është përcaktuar në aktet në fuqi në lidhje me mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave të operuara

- nga Banka e Shqipërisë, DTI-ja dhe DSPKF-ja njoftojnë njësinë përgjegjëse në Bankën e Shqipërisë që kryen këtë funksion.
- DTI-ja dhe DSPKF-ja konsultohen me njësinë përgjegjëse në Bankën e Shqipërisë që kryen funksionin e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë për të shqyrtuar ndikimet e mundshme që mund të kenë ndryshimet në lidhje me përputhshmërinë e sistemeve me parimet mbikëqyrëse.

KREU V **VEPRIMTARIA OPERACIONALE NË AIPS**

Neni 19 **Hapja e ditës së punës**

- DTI-ja kujdeset për të gjithë komponentët e infrastrukturës teknike për të garantuar disponueshmërinë e sistemit AIPS gjatë gjithë kohës së operimit.
- DTI-ja kujdeset për mirëfunksionimin e të gjitha elementeve të nevojshme të infrastrukturës për shkarkimin dhe garantimin e sigurisë maksimale në procesin e shkarkimit dhe importimit nga DSPKF-ja në sistemin AIPS, të listës së sanksioneve të publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
- DSPKF-ja shkarkon dhe importon në sistemin AIPS listën e përditësuar të sanksioneve sipas udhëzimeve të DTI-së.
- DSPKF-ja dhe DTI-ja duhet të sigurohen që hapat e përcaktuar për përditësimin në sistemin AIPS të listës së sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të jenë realizuar përpara orareve të përcaktuara për hapjen e ditës së punës së sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë dhe ditës së punës së sistemit AIPS EURO.
- Hapja e ditës së punës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe sistemin AIPS EURO mund të realizohet në formë automatike ose me ndërveprim të përdoruesit (manuale). DSPKF-ja vlerëson formën më të përshtatshme për realizimin e hapjes së ditës së punës dhe konfigururon sistemin në njërin prej dy formave, e cila mbahet e pandryshuar deri në një vlerësim të ndryshëm nga ky i fundit.
- Nëse forma e hapjes së ditës së punës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO është automatike, atëherë DSPKF-ja monitoron në çdo orar hapje të ditës së punës, statusin e realizimit të këtij procesi në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO.
- Nëse forma e hapjes së ditës së punës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO është manuale, atëherë DSPKF-ja, në përputhje me oraret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, ekzekuton procesin e hapjes së ditës së punës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO dhe monitoron ecurinë dhe statusin e realizimit të këtij procesi.

Neni 20 Mbyllja e ditës së punës

1. Në prag të përfundimit të ditës së punës, DSPKF-ja koordinon me DOM-in dhe DE-në për të evidentuar nëse kanë ende veprime për të cilat është i nevojshëm ndryshimi i orareve të operimit të sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë, dhe nëse vlerësohet e përshtatshme, kryen ndryshimin e orareve, në përputhje me nevojat e njësisë të Bankës së Shqipërisë.
2. Në rast se lind nevoja, ndryshimi i orareve të operimit të sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemit AIPS EURO dhe mbyllja e sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemit AIPS EURO duhet të shtrihet përtej orarit zyrtar, atëherë DSPKF-ja njofton DTI-në. Në këtë rast, DTI-ja kryen shtyrjen e orarit të sistemit SWIFT deri në një orar të përcaktuar sipas komunikimit me DSPKF-në, dhe, sipas rastit, përcakton njëërën nga mundësitë:
 - a) të lejohen mesazhe hyrëse dhe dalëse në AIPS;
 - b) të lejohen vetëm mesazhe dalëse nga AIPS.
3. Nëse në fund të ditës së punës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë ose në sistemin AIPS EURO ka transaksion në gjendje pezull për çështje përputhshmërie me listën e sanksioneve, atëherë DSPKF-ja njofton pjesëmarrësin që të kryejë anulimin e tij. Nëse pjesëmarrësi nuk është në gjendje të anulojë transaksionin, atëherë anulimin e transaksionit mund ta kryejë DSPKF-ja ose automatikisht sistemi në orarin e përcaktuar *cut-off*. Më pas mund të kryhet mbyllja e ditës së punës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë ose sistemin AIPS EURO.
4. Sa herë që evidentohen transaksione të filtruara sipas listës së sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, DSPKF-ja informon me shkresë zyrtare DM-në me të dhënat sipas raportit që gjeneron sistemi AIPS.
5. Mbyllja e ditës së punës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO mund të realizohet ose në formë automatike, ose me ndërveprim të përdoruesit (manuale). DSPKF-ja vlerëson formën më të përshtatshme për realizimin e mbylljes së ditës së punës dhe konfiguron sistemin në njëërën prej dy formave, e cila mbahet e pandryshuar deri në një vlerësim të ndryshëm nga ky i fundit.
6. Nëse forma e mbylljes së ditës së punës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO është automatike, atëherë DSPKF-ja monitoron në çdo orar mbylljeje të ditës së punës, statusin e realizimit të këtij procesi në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO.
7. Nëse forma e mbylljes së ditës së punës në sistemin AIPS është manuale, atëherë DSPKF-ja, në përputhje me oraret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, ekzekuton procesin e mbylljes së ditës së punës në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO dhe monitoron ecurinë dhe statusin e realizimit të këtij procesi.
8. Nëpërmjet mesazheve SWIFT dhe/ose njoftimeve automatike, sistemi njofton të gjithë pjesëmarrësit për mbylljen e ditës së punës

- në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemin AIPS EURO.
9. DTI-ja kujdeset për realizimin e procedurave teknike të përcaktuara në funksion të vazhdimësisë së biznesit për sistemin AIPS.

Neni 21 Monitorimi i sistemit

Monitorimi i sistemit AIPS kryhet bashkërisht nga DSPKF-ja dhe DTI-ja.

1. DSPKF-ja monitoron gjendjen e sistemit gjatë gjithë ditës së punës dhe në veçanti:
 - a) hapjen dhe mbylljen e ditës së punës;
 - b) shlyerjen e instruksioneve të pagesave në sistem;
 - c) shlyerjet neto dhe ato nga sistemet vartëse;
 - d) statusin e instruksioneve të pagesave në sistem;
 - e) evidentimin nëse konstatohet se ka transaksione në gjendje pezull për çështje përputhshmërie me listën e sanksioneve;
 - f) gjendjen e llogarive të pastrimit të sistemeve vartëse.
2. DTI-ja monitoron gjendjen teknike të sistemit AIPS gjatë gjithë ditës së punës dhe në veçanti:
 - a) hapjen dhe mbylljen e ditës së punës;
 - b) gjendjen e shërbimeve në funksion të sistemit AIPS;
 - c) gjendjen e infrastrukturës që ofron shërbimin e AIPS ndaj pjesëmarrësve;
 - d) gjurmët e aktivitetit të sistemit në drejtim të evidentimit të problematikave të mundshme.
3. DSPKF-ja ndjek rastet me pasaktësi në instruksionet e pagesave të iniciuara dhe/ose të mbërritura në favor të Bankës së Shqipërisë.
4. Në rast se DSPKF-ja, gjatë monitorimit të aktivitetit ditor, konstaton transaksione në gjendje pezull për çështje përputhshmërie me listën e sanksioneve, menjëherë kontakton me pjesëmarrësin për trajtimin e tij në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore.
5. Në rast se DSPKF-ja, gjatë monitorimit të aktivitetit ditor, vë re anomali në funksionimin e sistemit, menjëherë njofton DTI-në dhe për sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë edhe DOM-in me e-mail ose mjete të tjera komunikimi.
6. Në rast se DTI-ja, gjatë monitorimit të aktivitetit ditor të sistemeve që administron, vë re anomali të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikojnë elemente të mirëfunksionimit të sistemit AIPS, menjëherë njofton me e-mail DSPKF-në dhe, kur ka ndikim në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, edhe DOM-in.

Neni 22 Veprimet e Bankës së Shqipërisë si pjesëmarrëse

1. Veprimet e iniciuara nga Banka e Shqipërisë si pjesëmarrëse e sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë dhe/ose sistemit AIPS EURO përfshijnë:
 - a) instruksione të pagesave të gjeneruara automatikisht në sistemin AIPS nga ndërfaqësimi me sistemin e financës së Bankës së Shqipërisë;
 - b) instruksione të pagesave të regjistruara nga DSPKF-ja me urdhër

- të njësisë së financës së Bankës së Shqipërisë, në rastet kur këto instruksione nuk mund të gjenerohen automatikisht në sistemin AIPS;
- c) instruksione të pagesave të regjistruara nga DSPKF-ja për llogari të departamenteve të tjera të Bankës së Shqipërisë.
 2. Krahas veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ekzekutohen edhe veprimet e mbërritura në sistemin AIPS nga pjesëmarrësit në favor të Bankës së Shqipërisë.
 3. DSPKF-ja ndjek ecurinë e plotë të procesimit të instruksioneve të pagesave të iniciuara nga Banka e Shqipërisë dhe të mbërritura në favor të saj, që përfshin:
 - a) transmetimin e instruksioneve të pagesave në sistemin AIPS;
 - b) shlyerjen e instruksioneve të pagesave në sistemin AIPS;
 - c) dokumentimin e veprimeve në llogaritë përkatëse.

Neni 23

Shlyerja në AIPS e veprimeve të sistemeve vartëse

1. Në sistemin AIPS realizohet shlyerja e *cash*-it të veprimeve të iniciuara nga sistemet vartëse.
2. Transaksionet në AIPS për efekt të shlyerjes së veprimeve të origjinuara nga sistemet vartëse, gjenerohen nëpërmjet ndërfaqeve respektive me këto sisteme.
3. Sistemi AIPS proceson instruksionet me origjinë nga sistemet vartëse dhe në mungesë të fondeve të mjaftueshme, e vendos instruksionin e pagesës në radhën e pritjes, duke marrë parasysh radhën e përparësisë.
4. DSPKF-ja monitoron në sistemin AIPS transaksionet me origjinë nga sistemet vartëse dhe ndjek shlyerjen e tyre. Në rast mungese të fondeve, DSPKF-ja komunikon me departamentet përkatëse në Bankën e Shqipërisë, si dhe pjesëmarrësit.
5. Në rast se pranë *Cut-off* përfundimtar në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, evidentohen në radhën e pritjes transaksione të origjinuara nga sistemet vartëse për të cilat përgjegjës i sistemit është DOM-i, transaksione të regjistruara në sistem nga DOM-i, ose që i përkasin veprimtarisë së DOM-it, DSPKF-ja njofton DOM-in për t'u koordinuar për zgjidhjen e situatës.
6. Në rast pamundësie për të kryer një korigjim të nevojshëm nga ana e DOM-it në një transaksion të origjinuar nga sistemet vartëse për të cilat DOM-i është përgjegjës i sistemit, atëherë DOM-i udhëzon me shkresë zyrtare dhe në raste urgjente me e-mail me miratimin nga Drejtori ose në mungesë të tij Zëvendësdrejtori i DOM-it, për pasqyrimin e veprimit në AIPS manualisht nga DSPKF-ja.
7. Në rast pamundësie për të kryer një korigjim të nevojshëm nga ana e DE-së në një transaksion të origjinuar nga sistemet vartëse për të cilat DE-ja është përgjegjës i sistemit, atëherë DE-ja udhëzon me shkresë zyrtare dhe në raste urgjente me e-mail, duke bashkëngjitur të skanuar dokumentacionin dhe me miratimin nga Drejtori ose në mungesë të tij Zëvendësdrejtori i DE-së, për pasqyrimin e veprimit në AIPS manualisht nga DSPKF-ja.

8. Në fund të çdo dite pune, DSPKF-ja dhe DE-ja kryejnë rakordimin e llogarive të cilat preken nga aktiviteti i përbashkët, dhe komunikojnë konfirmimet me e-mail.
9. DOM-i dhe DE-ja, pasi kanë përfunduar aktivitetet e lidhura me sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, njoftojnë respektivisht DSPKF-në për të vijuar me mbylljen e ditës së punës.

Neni 24 **Veprimet për Ministrinë**

Në zbatim të rolit të Bankës së Shqipërisë bazuar në marrëveshjen e posaçme të lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë:

1. DTI-ja është përgjegjës për:
 - a) mbarëvajtjen e infrastrukturës dhe proceseve teknike të lidhura me Ministrinë në funksion të sistemit AIPS të shlyerjes në Lekë;
 - b) integritetin e transmetimit të informacionit në infrastrukturën për të cilën është përgjegjëse Banka e Shqipërisë;
 - c) dërgimin e raporteve elektronike të gjeneruara nga sistemi AIPS i shlyerjes në Lekë drejt Ministrisë, për gjendjet e llogarive të Ministrisë dhe listës së transaksioneve të iniciuara prej Ministrisë që nuk ka qenë e mundur të shlyhen në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë.
2. DSPKF-ja është përgjegjës për:
 - a) procesimin e instruksioneve të pagesave të Ministrisë në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë;
 - b) ndjekjen e procesit të shlyerjes së instruksioneve të pagesave të Ministrisë në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë;
 - c) mbajtjen e kontakteve dhe komunikimin me Ministrinë për rastet e pamjaftueshmërisë së fondeve dhe për të gjitha ngjarjet që pengojnë mbarëvajtjen e ndjekjes së procesit të shlyerjes;
 - d) dokumentimin e veprimeve të llogarive të Ministrisë.

Neni 25 **Veprimet për pjesëmarrësit e tjerë të tërthortë**

Në zbatim të akteve nënligjore apo procedurave nga të cilat buron e drejta për të kryer veprime financiare për pjesëmarrës të tërthortë të nënkategorive "ii." dhe "iii." në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, sipas kategorizimit të përcaktuar në rregulloren për sistemin AIPS, DSPKF-ja është përgjegjës për:

- a) procesimin e instruksioneve të pagesave të urdhëruara prej tyre;
- b) monitorimin e aktivitetit të lidhur me llogaritë e tyre;
- c) dokumentimin e veprimeve të këtyre llogarive.

Neni 26 **Rezerva e detyruar, interesat dhe gjobat**

1. DOM-i regjistron sipas periodicitetit të përcaktuar në kuadrin

- rregullativ, gjendjen e rezervave të detyruara në Lekë për secilën bankë pjesëmarrëse në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, normën e përdorimit të rezervës së detyruar, si dhe normën e remunerimit dhe normën e gjobave për mosplotësimin e rezervës së detyruar.
2. DOM-i gjeneron në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë përlllogaritjen e remunerimit dhe gjobave për secilën bankë pjesëmarrëse në të.
 3. Në pamundësi të realizimit të regjistrimit si në pikën 1 të këtij neni nga DOM-i, ajo paraqet sipas periodicitetit të përcaktuar në kuadrin rregullativ me shkresë zyrtare pranë DSPKF-së, gjendjen e rezervave të detyruara në Lekë për secilën bankë pjesëmarrëse në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, normën e përdorimit të rezervës së detyruar, si dhe normën e remunerimit dhe normën e gjobave për mosplotësimin e rezervës së detyruar, minimalisht një ditë pune përpara datës së regjistrimit të rezervës së detyruar në Lekë në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë.
 4. Në pamundësi të realizimit nga DOM-i, DSPKF-ja realizon regjistrimin e rezervave të detyruara në Lekë për secilën bankë pjesëmarrëse në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, si dhe normën e përdorimit të rezervës së detyruar, normën e remunerimit dhe normën e gjobave për mosplotësimin e rezervës së detyruar.
 5. Në pamundësi të realizimit nga DOM-i, DSPKF-ja gjeneron në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë përlllogaritjen e remunerimit dhe gjobave për secilën bankë pjesëmarrëse në të.
 6. Në çdo rast kur verifikohen pasaktësi në llogaritje, DSPKF-ja dhe DOM-i koordinojnë për kryerjen e saktësimeve.
 7. DSPKF-ja kryen përlllogaritjet për remunerimin e fondeve të mbetura gjendje në fund të çdo dite pune në llogarinë e shlyerjes në Euro të pjesëmarrësit në sistemin AIPS EURO, sipas mënyrës dhe normës së përcaktuar në aktet në fuqi.
 8. DSPKF-ja regjistron në llogaritë përkatëse të shlyerjes së bankave në Euro, interesin për remunerimin e fondeve gjendje në llogarinë e shlyerjes në Euro, me frekuencë sipas përcaktimeve në aktet në fuqi.

KREU VI

NGJARJET E PAPANASHIKUARA DHE SITUATAT E EMERGJENCËS

Neni 27

Administrimi i ngjarjeve të paparashikuara dhe situatave të emergjencës

1. Ngjarje e paparashikuar, në kuptimin e sistemit AIPS, konsiderohet çdo mosfunksionim në:
 - a) infrastrukturën e sistemit AIPS;
 - b) komponentë të infrastrukturës IT që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në mirëfunksionimin e sistemit AIPS.
2. Situatë emergjence, në kuptimin e sistemit AIPS, konsiderohet çdo

- ndërprerje e rëndësishme e funksionimit të shërbimit të sistemit AIPS.
3. Shpallja e situatës së emergjencës kryhet nga DSPKF-ja dhe DTI-ja, në bashkëpunim.
 4. Ngjarjet e paparashikuara dhe situatat e emergjencës administrohen nga DTI-ja dhe DSPKF-ja, në bashkëpunim dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
 5. Në çdo rast kur DTI-ja konstaton një ngjarje të paparashikuar apo situatë emergjence në kuptimin e sistemit AIPS, njofton menjëherë DSPKF-në dhe, kur ka ndikim në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë, edhe DOM-in.
 6. Në çdo rast kur DSPKF-ja konstaton një mosfunksionim në sistemin AIPS, njofton menjëherë DTI-në.
 7. Menjëherë pas konstatimit të një ngjarjeje të paparashikuar apo të një situatë emergjence në kuptimin e sistemit AIPS, DTI-ja merr masa për zgjidhjen e saj.
 8. DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë për formulimin e njoftimit për pjesëmarrësit në rast se do të jetë e nevojshme.
 9. Në rast se brenda 30 minutave nga konstatimi i ngjarjes së paparashikuar apo situatës së emergjencës, problematika nuk është zgjidhur dhe mosfunksionimi ndikon operacionet e pjesëmarrësve në sistemin AIPS, DSPKF-ja dërgon me mesazh SWIFT dhe/ose e-mail njoftimin për pjesëmarrësit e sistemit, sipas formulimit të përbashkët me DTI-në.
 10. Në rast se për shkak të ngjarjes së paparashikuar apo situatës së emergjencës, rivënia në punë e sistemit AIPS primar është e pamundur, DTI-ja realizon procedurat për kalimin në sistemin *backup*.
 11. DTI-ja, në bashkëpunim me DSPKF-në, udhëzon pjesëmarrësit për hapat që duhet të ndjekin për kalimin në sistemin *backup* dhe vazhdimin e veprimeve operacionale.
 12. Me rikthimin e situatës në normalitet dhe kalimin në sistemin AIPS primar, gjithashtu DTI-ja, në bashkëpunim me DSPKF-në, udhëzon pjesëmarrësit.
 13. Menjëherë pas zgjidhjes së situatës, DSPKF-ja njofton pjesëmarrësit me mesazh SWIFT dhe/ose e-mail.
 14. Ngjarjet e paparashikuara dhe situatat e emergjencës të lidhura me sistemin AIPS raportohen në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Neni 28 Forca madhore

1. Në rastin e situatave që krijohen si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme, luftërave, turbullirave të tjera civile, fatkeqësive natyrore dhe për çdo rrethanë tjetër jashtë kontrollit të Bankës së Shqipërisë si operator i sistemit dhe pjesëmarrësve në sistem, si dhe si pasojë e çdo force tjetër madhore, drejtuesit e DTI-së dhe DSPKF-së, kur është e mundur, vendosin për ndërprerjen e menjëhershme të operimit të sistemit AIPS, me qëllim mbrojtjen e pajisjeve, të

- dhënave, si dhe komponentëve të tjerë mbështetës të tij.
2. Me përfundimin e ngjarjeve që përbëjnë forcë madhore, DTI-ja dhe DSPKF-ja ndërmarrin hapat e nevojshëm për rifillimin e operimit të sistemit AIPS, duke monitoruar dhe duke kontrolluar në mënyrë të hollësishme transaksionet në sistemin AIPS.
 3. DTI-ja dhe DSPKF-ja kryejnë analiza mbi aktivitetin dhe mbi bashkëveprimin e njësive të Bankës së Shqipërisë gjatë rasteve të forcave madhore, si dhe mbi përpjekjet e bëra për të mundësuar kthimin e aktivitetit operacional në sistem. Kur shihet e nevojshme, propozohen masa për përmirësime të procedurave dhe/ose të konfigurimeve të sistemeve dhe pajisjeve.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29 Organizimi i brendshëm

1. Organizimi i brendshëm i punës brenda njësive organizative të Bankës së Shqipërisë të përmendura në këtë rregullore, për ushtrimin e funksioneve dhe zbatimin e detyrave të përcaktuara nga dispozitat e kësaj rregulloreje, përcaktohet nëpërmjet manualeve përkatëse të veprimitarisë për çdo njësi organizative përbërëse, si dhe në përshkrimet e vendeve të punës së punonjësve.
2. Manualet dhe përshkrimet e vendeve të punës, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, hartohen në përputhje me manualet e përdorimit të sistemit AIPS dhe me dispozitat e rregulloreve të organizimit dhe funksionimit të departamenteve përkatëse.
3. Matrica e korrespondencës së funksionaliteteve të sistemit AIPS, të cilat i përkasin roleve të përcaktuara për dhënien e aksesit përdoruesve në funksion të kryerjes së detyrave të tyre operacionale në sistemin AIPS, miratohet nga drejtuesit e DTI-së dhe DSPKF-së.
4. Kalendari i anëtarësimit të pjesëmarrësit në sistemin AIPS të shlyerjes në Lekë dhe në sistemin AIPS EURO është subjekt i veçantive që lidhen me ndryshimet teknologjike dhe përditësimet e herëpashershme, të cilave u nënshtrohet sistemi AIPS, dhe hartohet rast pas rasti nga DSPKF-ja dhe DTI-ja në bashkëpunim, si dhe miratohet nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së.

Neni 30 Hyrja në fuqi

Rregullorja hyn në fuqi pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO



SHTOJCA A
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE DHE I KONTABILITETIT DHE FINANCËS
KËRKESË PËR APROVIM PROFILI PËRDORUESI NË AIPS

Drejtori i

Departamentit kërkues

(_____)

Tiranë, më _____ / _____ / _____

Departamenti: _____

Spektori: _____

Drejtori i DSPKF

(_____)

Punonjësit: _____ me detyrë: _____ t'i jepen të drejtat si më poshtë:

Nr.	Aplikacioni AIPS	Përdorues	Nr.	Aplikacioni PO	Përdorues
1	Aprovues Execute AIPS	<input type="checkbox"/>	1	Operator AIPS	<input type="checkbox"/>
2	Operator Execute AIPS	<input type="checkbox"/>	2	Aprovues AIPS	<input type="checkbox"/>
3	Operator AIPS	<input type="checkbox"/>	3	Operator Enter (AIPS & AECH)	<input type="checkbox"/>
4	Operator RD	<input type="checkbox"/>	4	Operator Approve (AIPS & AECH)	<input type="checkbox"/>
5	Aprovues RD	<input type="checkbox"/>	5	Operator Back Office	<input type="checkbox"/>
6	Monitorues	<input type="checkbox"/>	6	Aprovues Back Office	<input type="checkbox"/>
7	Monitorues BSH	<input type="checkbox"/>	7	Monitorues MF	<input type="checkbox"/>
8	Monitorues MF	<input type="checkbox"/>			
9	BOA_Security_Officer	<input type="checkbox"/>			


Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	
Punonjësi	_____
Username	_____
Krijoi	_____
Kontrolli	_____

Drejtori i DTI

(_____)

		Data	Nënshkrimi (Firma)

SHTOJCA B

 KONFIDENCIAL BANKA E SHQIPËRISË DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT FORMULARI I KËRKESËS PËR CERTIFIKATË DIGJITALE AIPS			
Të plotësohet ky formular për të administruar certifikatat digjitale të përdoruesve të Bankës së Shqipërisë lidhur me sistemin AIPS			
Departamenti Kërkues			
Drejtori i Departamentit Kërkues (Emri Mbiemri / Nënshkrimi)		Data e kërkesës: __/__/__ (dd/mm/vvvv)	
KËRKESË PËR CERTIFIKATA DIGJITALE			
Nr.	Emri/Mbiemri i përdoruesit	Veprimi	
1		<input type="checkbox"/> Gjenerim certifikate të re	
		<input type="checkbox"/> Rigjenerim certifikate	
		<input type="checkbox"/> Zhblokim pajisjeje sigurie	
		<input type="checkbox"/> Rivendosje fjalëkalimi pajisjeje sigurie	
		<input type="checkbox"/> Revokim certifikate	
Shënim:			
Drejtori i DSPKF (Emri Mbiemri / Nënshkrimi)		Drejtori i DTI (Emri Mbiemri / Nënshkrimi)	
Departamenti i Teknologjisë së Informacionit			
Punonjësi			
Username		Data	Nënshkrimi (Firma)
Krijoi			
Kontrolloi			



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 47, datë 3.9.2025

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
"PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË
KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL – AECH"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 4, shkronja "dh", si dhe neneve 14, 21, dhe 43, shkronja "f" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 13 të ligjit nr. 133, datë 29.4.2013, "Për sistemin e pagesave"; nenit 129, pika 6, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për organizimin e brendshëm të funksionimit të sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 37, datë 3.6.2020, "Për miratimin e rregullores "Për organizimin e brendshëm të funksionimit të sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH".
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave të brendshme për administrimin, operimin dhe organizimin e sistemit AECH nga Banka e Shqipërisë.
2. Subjekte të kësaj rregulloreje janë njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 2 Baza juridike

Për zbatimin e kësaj rregulloreje, njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë mbështeten në legjislacionin e mëposhtëm:

- a) ligjin "Për Bankën e Shqipërisë";
- b) ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
- c) ligjin "Për sistemin e pagesave";
- d) rregulloren "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)";
- e) aktet e tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë që lidhen, por nuk kufizohen me: funksionimin e sistemeve të pagesave, minimumin e rezervës së detyruar, instrumentet e pagesave elektronike, kredinë brenda ditës për bankat, kredinë njëditore për bankat, sigurinë e informacionit, administrimin e rrezikut operacional etj.

Neni 3 Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të rregullores, termat e përkufizuar në rregulloren "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH" kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore.
2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të rregullores, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) DM – është Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë;
 - b) DSPKF – është Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës në Bankën e Shqipërisë, i cili, në cilësinë e përgjegjës të sistemit, përcakton kriteret për trajtimin, administrimin dhe aksesimin e sistemit, si dhe pranon dhe miraton ndryshimet apo përmirësimet e mundshme në lidhje me funksionet operacionale të sistemit;
 - c) DTI – është Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në Bankën e Shqipërisë, i cili, në cilësinë e kujdestarit të sistemit, kujdeset për sistemin, duke e administruar teknikisht atë dhe infrastrukturën mbështetëse të tij, si dhe duke zbatuar dhe mbrojtur rregullat e përcaktuara nga përgjegjësi i sistemit;
 - d) Ministria – është ministria përgjegjëse për financat;
 - e) Rregullorja për sistemin AECH – është rregullorja e Bankës së

- Shqipërisë "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël - AECH" dhe çdo ndryshim i saj;
- f) Shtojca – janë dokumentet A dhe B që i bashkëlidhen kësaj rregulloreje dhe janë pjesë përbërëse e saj.

KREU II FUNKSIONET E DEPARTAMENTEVE NË SISTEMIN AECH

Neni 4 Funksionet e DSPKF-së

DSPKF-ja në sistemin AECH ushtron funksionet e mëposhtme:

1. Është përgjegjës i sistemit AECH;
2. Administron operacionalisht sistemin AECH;
3. Zbaton politikën e sigurisë në sistemin AECH në cilësinë e përgjegjësit të sistemit;
4. Faturon detyrimet e pjesëmarrësve për shërbimet e sistemit AECH të ofruara nga Banka e Shqipërisë, duke bërë regjistrimet përkatëse në sistemet e vendosura në dispozicion nga autoritetet përgjegjëse. Ekzekuton dhe ndjek shlyerjen e pagesave të tyre në sistemin AIPS;
5. Kur është e nevojshme, kryen ndryshimin e orareve të operimit të sistemit AECH në përputhje me aktet nënligjore në fuqi;
6. Kryen procedurat për kufizimin e përkohshëm dhe/ose përjashtimin e pjesëmarrësit në sistemin AECH, si dhe njofton për këtë pjesëmarrësit e sistemit;
7. Përfaqëson Bankën e Shqipërisë si pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në sistemin AECH, duke pasqyruar, procesuar dhe monitoruar transaksionet e regjistruara për qëllime të aktivitetit të saj;
8. Pas kërkesës me shkresë zyrtare të pjesëmarrësit, të nënshkruar nga nënshkrimet e autorizuar sipas rregullit dhe klasifikimit, të njoftuara zyrtarisht nga pjesëmarrësi, ose me mesazh SWIFT të autentifikuar, në raste të lidhura me mosfunksionime në infrastrukturën pranë pjesëmarrësit, kur është e aplikueshme kryen aprovimin e instruksioneve të pagesave të pjesëmarrësit në sistemin AECH;
9. Me kërkesë të pjesëmarrësit, kryen ndryshimin e radhitjes së urdhërpagesave të pjesëmarrësit në përputhje me rregulloren për sistemin AECH;
10. Ndërhyn për anulimin e një urdhërpagese të pushyer në radhë, nëse kjo gjë kërkohet nga pjesëmarrësi;
11. Përgatit dhe publikon statistika mbi veprimtarinë në sistemin AECH;
12. Bashkëpunon me departamentet e tjerë në lidhje me zbatimin e rregulloreve të sistemit AECH;
13. Mban dhe përditëson listën e personave të kontaktit të çdo pjesëmarrësi për sistemin AECH, si dhe njofton pjesëmarrësit për listën e përditësuar të personave të kontaktit të Bankës së Shqipërisë për sistemin AECH;
14. Mban dhe përditëson listën e nënshkrimeve të autorizuar (të

- shoqëruar me kategoritë dhe limitet përkatëse) të pjesëmarrësve, që përdoren për sistemin AECH;
15. Për çdo shkresë zyrtare, formular apo raport që adresohet në Bankën e Shqipërisë në lidhje me sistemin AECH, kryen verifikimin e nënshkrimeve të autorizuar, aty ku është e aplikueshme, përpara se të kryhen veprime të mëtejshme nga njësitë e tjera apo vetë DSPKF-ja. Pas verifikimit me sukses të nënshkrimeve të autorizuar, përcjell shkresën e mbërritur me korrespondencë zyrtare për në njësinë përgjegjëse të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e veprimeve të mëtejshme;
 16. I dërgon shkresë zyrtare pjesëmarrësit, për çdo rast të shkeljes së detyrimeve të pjesëmarrësit në sistemin AECH;
 17. Informon DM-në për çdo rast të evidentuar të shkeljeve të detyrimeve të pjesëmarrësve në sistemin AECH, sipas akteve nënligjore në fuqi;
 18. Informon dhe bashkëpunon me DM-në për raste ku pjesëmarrësit në sistemin AECH paraqesin problematika në sistemin e pagesave me ndikim në sistemin bankar apo financiar në tërësi;
 19. Raporton pranë njësisë përgjegjëse për administrimin e rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë, mbi ngjarjet e rrezikut operacional të lidhura me sistemin AECH në këndvështrimin operacional.

Neni 5 Funksionet e DTI-së

DTI-ja në sistemin AECH ushtron funksionet e mëposhtme:

1. Është kujdestar i sistemit AECH;
2. Administron dhe mirëmban teknikisht sistemin AECH dhe infrastrukturën mbështetëse të tij, përfshirë shërbimet përkatëse të SWIFT në funksion të sistemit AECH;
3. Zbaton politikën e sigurisë në sistemin AECH në cilësinë e kujdestarit të sistemit, dhe ndërton mekanizma të sigurt për:
 - i. mbrojtjen e aksesit ndaj tij,
 - ii. autentifikimin e dërguesit të instruksionit të pagesës,
 - iii. mbrojtjen e besueshmërisë dhe të konfidencialitetit të informacionit të marrë dhe të ruajtur nga sistemi AECH.
4. Shqyrton kërkesat nga përdoruesit për zhvillime të reja në sistemin AECH dhe pas vlerësimit të mundësive të realizimit, ndërmerr hapat e nevojshëm sipas rastit në bashkëpunim me DSPKF-në, për implementimin e tyre në sistem;
5. Ndërton mekanizma për evidentimin e incidenteve dhe problemeve lidhur me funksionimin e sistemit AECH dhe infrastrukturës që e mbështet;
6. Mban regjistrin e anomalive/problematikave të identifikuar ose të sinjalizuara në lidhje me sistemin AECH, si dhe merr masa për zgjidhjen e tyre. Në rast se zgjidhja e anomalisë është jashtë mundësive teknike dhe kompetencave të DTI-së, atëherë DTI-së njofton kompaninë kontraktore që ka ofruar sistemin AECH dhe shërbimin e mirëmbajtjes së tij, për të asistuar në zgjidhjen e saj;

7. Zbaton në sistem procedurat për vendosjen e versioneve të reja, si dhe kryen përditësimet në përputhje me instruksionet e dhëna nga kompania kontraktore që ka ofruar sistemin AECH;
8. Administron teknikisht përdoruesit dhe të drejtat në sistem;
9. Administron formularët/kërkesat për përdorues dhe ndryshime në VPN, pajisje sigurie, certifikata digjitale dhe përdorues të lidhur me sistemin AECH, të paraqitura nga DSPKF-ja si përgjegjës i sistemit;
10. Harton dhe zbaton procedurat *Fallback-Recovery* dhe *Backup-Restore* në funksion të vazhdimësisë së veprimtarisë, i teston periodikisht ato, si dhe informon DSPKF-në mbi rezultatet;
11. Shqyrton njoftimin e pjesëmarrësit për raste kur ai pjesëmarrës raporton për teste ose ndryshime infrastrukturore, të cilat mund të ndikojnë aftësinë e tij për të operuar në sistemin AECH dhe e udhëzon atë sipas rastit;
12. Informon DSPKF-në për çdo rast të evidentuar të shkeljeve të detyrimeve teknike të pjesëmarrësve në sistemin AECH, me qëllim që DSPKF-ja të vijojë me njoftimin e DM-së, sipas akteve nënligjore në fuqi;
13. Raporton pranë njësisë përgjegjëse për administrimin e rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë, mbi ngjarjet e rrezikut operacional të lidhura me sistemin AECH në këndvështrimin teknik.

Neni 6

Funksione të përbashkëta mes DSPKF-së dhe DTI-së

DSPKF-ja dhe DTI-ja, në sistemin AECH, ushtrojnë funksione të përbashkëta si më poshtë:

1. Zbatojnë rregullat për sigurinë e informacionit, në funksion të garantimit të parimeve të sigurisë: disponueshmërisë, konfidencialitetit, integritetit, aksesit të kontrolluar në sistem;
2. Ndjekin procedurat për anëtarësimin e pjesëmarrësve të rinj në sistemin AECH;
3. Ndjekin procedurat për administrimin e AECH CUG dhe shërbimit përkatës të SWIFT;
4. Mbajnë kontaktet dhe mbështesin pjesëmarrësit në operimin në sistemin AECH, përkatësisht DSPKF-ja për çështjet operationale dhe DTI-ja për çështjet teknike e infrastrukturore;
5. Administrojnë ngjarjet e paparashikuara dhe situatat e emergjencës në sistemin AECH, si dhe mbajnë kontakt me pjesëmarrësit për t'i informuar dhe asistuar ata në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore;
6. Janë pikë kontakti me kompaninë kontraktore që ka ofruar sistemin AECH dhe ofron shërbimin e mirëmbajtjes së AECH, si dhe ndjekin zbatimin e kontratave me të;
7. Shqyrtojnë raportimet e pjesëmarrësve të sistemit AECH në lidhje me ngjarjet e paparashikuara të regjistruara pranë pjesëmarrësit dhe ecurinë e tyre deri në zgjidhje, raportet e incidentit, si dhe raportin e vetëvlerësimit të pjesëmarrësit për operimin në sistemin AECH. Nëse DTI-ja konstaton elemente teknike, të cilët mund të kenë ndikim në operacionet në sistemin AECH ose në aftësinë e

- pjesëmarrësit për të operuar në sistemin AECH, ia vë në vëmendje ato DSPKF-së;
8. Bashkëpunojnë gjatë proceseve të testimeve në sistemin AECH në mjedisin e dedikuar për këtë qëllim;
 9. Bashkëpunojnë për ndjekjen, koordinimin dhe monitorimin e testimeve që kryhen në sistem nga subjekte në proces licencimi si subjekte bankare dhe që kanë lidhur marrëveshje për të kryer testime paraprake në mjedisin test të sistemit AECH;
 10. Bashkëpunojnë për përcaktimin e matricës së korrespondencës së funksionaliteteve të sistemit AECH që i përkasin roleve për të drejtat e përdoruesve në sistemin AECH;
 11. Bashkëpunojnë gjatë procesit të testimi të procedurave *Fallback-Recovery*;
 12. Bashkëpunojnë për hartimin e raporteve mbi incidente apo ngjarje të paparashikuara në infrastrukturën pranë Bankës së Shqipërisë, që ndikojnë në disponueshmërinë e shërbimit të sistemit AECH për pjesëmarrësit;
 13. Raportojnë, në përputhje me aktet e miratuara në fuqi në lidhje me mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë, pranë njësisë përgjegjëse në Bankën e Shqipërisë që kryen këtë funksion;
 14. Bashkëpunojnë për formulimin e njoftimeve për pjesëmarrësit në rastet e ngjarjeve të paparashikuara, situatave të emergjencës, apo aplikimit të ndryshimeve në sistem, kur këto ndryshime kanë ndikim në veprimtarinë operacionale të pjesëmarrësve. Nëse shihet e nevojshme të jepen instruksione të mëtejshme, ato dërgohen përkatësisht nga DSPKF për detajet operacionale dhe nga DTI për detajet teknike e infrastrukture;
 15. Në rastet kur kërkohet zyrtarisht nga një pjesëmarrës informacion mbi të dhëna të arkivuara dhe të paaksesueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në sistemin AECH, DTI siguron informacionin e kërkuar në një format të përshtatshëm, dhe DSPKF-ja harton raportin informues për pjesëmarrësin brenda afatit të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi;
 16. Hartojnë akte nënligjore të nevojshme për mirëfunksionimin dhe sigurinë e sistemit.

Neni 7 Funksionet e DM-së

DM-ja, në lidhje me sistemin AECH, ushtron funksionet e mëposhtme:

1. Nëse gjatë proceseve të inspektimit të ushtruara nga DM-ja te subjektet pjesëmarrëse në sistemin AECH dhe që mbikëqyren nga DM-ja, verifikohet se komisionet bankare të aplikuara nga ato subjekte ndaj klientëve të tyre për urdhërpagesa në nisje dhe në mbërritje në sistemin AECH, janë mbi kufijtë e përcaktuar në rregullat e funksionimit të sistemit AECH, atëherë DM-ja njofton me shkresë zyrtare DSPKF-në për rastin e verifikuar të shkeljes së rregullores për sistemin AECH;

2. Në përfundim të inspektimit të plotë ose të pjesëshëm të kryer nga ana e DM-së pranë subjekteve bankare, i përcjell DSPKF-së rezultatet e inspektimit lidhur me sistemet e pagesave që operohen nga Banka e Shqipërisë. Përcjellja e rezultateve mund të bëhet me shkresë zyrtare ose në format elektronik nga/për punonjësit e përcaktuar nga Drejtuesi i njësisë përkatëse;
3. Njofton pa vonesë DSPKF-në në raste kur nga DM-ja evidentohet se një subjekt pjesëmarrës në sistemin AECH paraqet vështirësi financiare, apo është vendosur në një status të caktuar me ndikim në sistemin e pagesave, është në proces likuidimi/falimentimi, si dhe kur evidentohen zhvillime në sektorin bankar me ndikim në sistemin e pagesave;
4. Njofton pa vonesë DSPKF-në në çdo rast kur nis një proces bashkimi/përthithjeje e një banke me/nga një/disa bankë/a në një të vetme, në çdo rast kur nis një vendosje në proces likuidimi/falimentimi, si dhe kur nis një proces pezullimi apo revokimi (shfuqizimi) i licences së një subjekti, i cili mbikëqyret nga DM-ja dhe është pjesëmarrës në sistemet e pagesave.

KREU III PJESËMARRJA NË SISTEMIN AECH

Neni 8 Procedurat e anëtarësimit

Procedurat e anëtarësimit si pjesëmarrës në AECH ndiqen nga DSPKF-ja dhe DTI-ja, në bashkëpunim me kandidatin për pjesëmarrës, si dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Këto procedura kalojnë në hapat e mëposhtme:

1. DSPKF-ja merr në shqyrtim kërkesën zyrtare të kandidatit për anëtarësim në sistemin AECH, dhe informon kandidatin për miratimin ose jo të kërkesës së tij. Nëse kërkesa e kandidatit miratohet, atëherë vijohet me hapat e tjerë;
2. Informimi dhe asistenca teknike për kandidatin në procesin e anëtarësimit
 - a) DSPKF-ja informon kandidatin mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin me anëtarësimin e tij si pjesëmarrës në sistemin AECH duke i vënë në dispozicion aktet nënligjore në fuqi lidhur me sistemin AECH, si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm;
 - b) DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë për hartimin, rast pas rasti, të kalendarit të detajuar me hapat teknikë të anëtarësimit dhe DSPKF-ja ia komunikon atë kandidatit;
 - c) DTI-ja informon kandidatin mbi infrastrukturën teknike që duhet të ketë në dispozicion dhe për detaje të tjera të lidhura me parametrat dhe kushtet teknike që infrastruktura duhet të plotësojë, si dhe e asiston teknikisht atë;
 - d) DTI-ja vë në dispozicion të kandidatit mjetet e duhura, aty ku është

- e aplikueshme, si dhe dokumentacionin teknik të nevojshëm për kryerjen e instalimeve dhe implementimin e infrastrukturës së duhur për operimin e kandidatit në sistemin AECH;
- e) DTI-ja dhe DSPKF-ja udhëzojnë dhe ndjekin procesin e anëtarësimit të kandidatit në AECH CUG dhe shërbimin përkatës të SWIFT.
3. Testimi dhe trajnimi i kandidatit
 - a) DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë për trajnimin e përdoruesve të ardhshëm të kandidatit për funksionet e sistemit AECH;
 - b) DTI-ja dhe DSPKF-ja në bashkëpunim me kandidatin kryejnë testimet e nevojshme në sistemin AECH;
 - c) DTI-ja në bashkëpunim me kandidatin kryen testime për elementet teknike të infrastrukturës që do të mbështesë operimin e kandidatit në sistemin AECH.
 4. Aksesimi i sistemit TEST
 - a) DTI-ja pajis kandidatin me certifikatat dhe pajisjet e sigurisë, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AECH;
 - b) DTI-ja krijon përdoruesit e kandidatit në VPN, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AECH;
 - c) DTI-ja krijon dy oficerët e sigurisë së kandidatit në sistemin TEST, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AECH.
 5. Përgatitja e dokumentacionit
 - a) DSPKF-ja dhe DTI-ja këshillojnë kandidatin gjatë procesit të hartimit të dokumentacionit dhe bazës rregullative mbi:
 - i. operimin në sistemin AECH;
 - ii. sigurinë e transmetimit të informacionit/instruksiioneve nga sistemet e tij për në sistemin AECH;
 - iii. planet e emergjencës.
 6. Pranimi në anëtarësim
 - a) DTI-ja dhe DSPKF-ja shqyrtojnë plotësimin e dokumentacionit dhe bazës rregullative, si dhe plotësimin e të gjitha kushteve për pjesëmarrje në sistemin AECH nga ana e kandidatit, dhe nëse e vlerësojnë të plotë dokumentacionin dhe vlerësojnë se kandidati i plotëson të gjitha kushtet, vijojnë me hapat e tjerë;
 - b) DSPKF-ja ruan dokumentacionin e anëtarësimit të kandidatit, përfshirë marrëveshjen e pjesëmarrjes së kandidatit.
 7. Aktivizimi i pjesëmarrësit
 - a) DSPKF-ja krijon pjesëmarrësin në sistemin AECH pas nënshkrimit të marrëveshjes tip të pjesëmarrjes në sistemin AECH;
 - b) DSPKF-ja njofton pjesëmarrësit e tjerë për anëtarësimin e pjesëmarrësit të ri 10 (dhjetë) ditë pune përpara datës në të cilën ky pjesëmarrës fillon veprimtarinë *live* në sistemin AECH;
 - c) DTI-ja pajis pjesëmarrësin me certifikatat dhe pajisjet e sigurisë, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AECH;
 - d) DTI-ja krijon përdoruesit e pjesëmarrësit në VPN, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AECH;
 - e) DTI-ja krijon dy oficerët e sigurisë së pjesëmarrësit në sistemin LIVE, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AECH.

Neni 9 Kufizimi i përkohshëm dhe përjashtimi

Kufizimi i përkohshëm apo përjashtimi i një pjesëmarrësi në sistemin AECH kryhet nga DSPKF-ja pasi është konsultuar më parë me DM-në, dhe miratohet nga Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë.

KREU IV ADMINISTRIMI I SISTEMIT AECH

Neni 10 Administrimi i pjesëmarrësit

Në drejtim të administrimit të pjesëmarrësit në sistemin AECH, DSPKF-ja kryen funksionet e mëposhtme:

1. Krijon pjesëmarrësin në sistemin AECH dhe kryen njoftimet përkatëse, siç është përcaktuar në procedurat e anëtarësimit;
2. Me kërkesë/njoftim të pjesëmarrësit, modifikon/përditëson detaje të pjesëmarrësit, si adresa, personat e kontaktit, etj.;
3. Bazuar në vendime për ndryshime në lidhje me subjektin pjesëmarrës, kryen modifikimin/përditësimin e pjesëmarrësit dhe/ose llogarisë teknike të pjesëmarrësit në sistemin AECH;
4. Kufizon përkohësisht aksesin e pjesëmarrësit në sistemin AECH dhe/ose përjashton pjesëmarrësin nga sistemi AECH, si dhe kryen njoftimet përkatëse në përputhje me aktet nënligjore në fuqi;
5. Në rastin e kufizimit të përkohshëm apo të përjashtimit të një pjesëmarrësi nga sistemi AECH, diskuton paraprakisht dhe koordinon me DM-në për procedurat që do të ndiqen;
6. Në raste të përjashtimit të një pjesëmarrësi nga sistemi AECH:
 - a) njofton me shkresë zyrtare DM-në për ekzekutimin e mbylljes së llogarisë teknike të pjesëmarrësit,
 - b) njofton me shkresë zyrtare DTI-në për të kryer fshirjen/bllokimin e përdoruesve të pjesëmarrësit nga sistemi AECH, si dhe për të marrë masat e nevojshme në lidhje me AECH CUG dhe shërbimin përkatës të SWIFT për këtë pjesëmarrës.

Neni 11 Administrimi i përdoruesve

1. DSPKF-ja në cilësinë e përgjegjësit të sistemit AECH dhe DTI-ja në cilësinë e kujdestarit të sistemit AECH, në bashkëpunim, përcaktojnë matricën e korrespondencës së funksionaliteteve të sistemit AECH, që i përkasin roleve për të drejtat e përdoruesve bazuar në aktivitetin operacional që duhet të kryejnë, duke pasur në vëmendje parimet bazë të "katër syve" dhe të të drejtave minimale në sistemin AECH.
2. DTI-ja, në cilësinë e kujdestarit të sistemit, realizon veprimet e mëposhtme në lidhje me administrimin e përdoruesve të sistemit

AECH:

- a) krijon teknikisht rolet për të drejtat e përdoruesve në sistemin AECH, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni;
- b) krijon përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në sistemin AECH test pas miratimit me e-mail të drejtuesit të DSPKF-së;
- c) krijon, modifikon ose fshin përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në sistemin AECH primar, sipas kërkesës së nënshkruar nga drejtuesi i Departamentit kërkues, dhe të miratuar nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së, sipas Shtojcës A bashkëlidhur;
- d) administron certifikatat digjitale për përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në lidhje me sistemin AECH, sipas kërkesës së nënshkruar nga drejtuesi i Departamentit kërkues, dhe të miratuar nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së, sipas Shtojcës B bashkëlidhur;
- e) bazuar në aktet nënligjore në fuqi, për përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në sistemin AECH, modifikon statusin e llogarisë së përdoruesit dhe/ose rivendos fjalëkalimin e tij në përputhje me kërkesën për ndryshim në llogarinë e përdoruesit nga drejtuesi i Departamentit përkatës, si dhe zotëruesi i llogarisë në rastin e rivendosjes së fjalëkalimit;
- f) krijon, modifikon ose fshin përdorues të një pjesëmarrësi, si dhe rivendos fjalëkalim të përdoruesit të pjesëmarrësit në rast pamundësie të kryerjes së kësaj procedure nga vetë pjesëmarrësi, sipas përcaktimeve në rregulloren për sistemin AECH;
- g) rinovon çdo vit certifikatat digjitale të përdoruesve të pjesëmarrësve në sistemin AECH, të paraqitura prej tyre në Bankën e Shqipërisë në përfundim të afatit të skadencës, sipas përcaktimeve në rregulloren për sistemin AECH.

Neni 12

Administrimi i kalendarit

Në bazë të njoftimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë mbi kalendarin e festave zyrtare, DSPKF-ja:

- a) plotëson kalendarin për vitin pasardhës para fillimit të vitit të ri ushtrimor;
- b) ndryshon kalendarin dhe njofton pjesëmarrësit, në çdo rast ndryshimi të planifikuar, kur është e mundur jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune përpara datës së kryerjes së këtyre ndryshimeve.

Neni 13

Administrimi i orareve të operimit

1. DSPKF-ja ndryshon oraret e operimit në sistemin AECH në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe pasi vlerëson rrethanat në të cilat lind nevoja për ndryshim të orareve, duke përfshirë këtu:
 - a) ngjarje të paparashikuara dhe situata emergjence;
 - b) kërkesë nga një njësi e Bankës së Shqipërisë;
 - c) kërkesë nga një pjesëmarrës.
2. DSPKF-ja ndryshon numrin e seancave të klerimit në përputhje me

aktet nënligjore në fuqi dhe pasi vlerëson rrethanat në të cilat lind nevoja për ndryshim, duke përfshirë këtu:

- a) ngjarje të paparashikuara dhe situata emergjence;
 - b) kërkesë individuale nga një pjesëmarrës brenda një afati të përshtatshëm kohor.
3. Pjesëmarrësit e sistemit AECH lajmërohen për ndryshimin e orareve apo të seancave të klerimit nëpërmjet njoftimeve automatike të sistemit ose nga DSPKF-ja me e-mail ose mesazh SWIFT.

Neni 14 **Testimi dhe ndryshimet në sistem**

1. Çdo kërkesë për ndryshim në sistemin AECH vlerësohet nga DSPKF-ja dhe DTI-ja përkatësisht në cilësinë e përgjegjës të sistemit dhe kujdestarit të sistemit, dhe miratohet prej tyre për t'u zbatuar kur çmohet e arsyeshme.
2. Në rastet kur ndryshimet e propozuara kanë ndikime tek pjesëmarrësit e tjerë të sistemit AECH, DSPKF-ja dhe DTI-ja këshillohen paraprakisht me këta të fundit.
3. DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë në kryerjen e testeve në raste kur lind e nevojshme të shqyrtohen sjellje funksionale të sistemit, ndërveprime të tij me sisteme të tjera, përditësime të ofruara nga kompania kontraktore që kryen mirëmbajtjen e sistemit AECH, si dhe kur evidentohen problematika në funksionim.
4. Çdo ndryshim duhet të aplikohet në sistemin AECH vetëm pasi të jetë testuar në mjedisin e dedikuar për testim, dhe pas miratimit nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së. DTI kujdeset që aplikimi i ndryshimeve në sistemin AECH të kryhet në të dy mjediset, primar dhe *backup*.
5. Në lidhje me ndryshime të rëndësishme, të cilat prekin aspekte të caktuara të sistemit AECH, siç është përcaktuar në aktet në fuqi në lidhje me mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë, DTI-ja dhe DSPKF-ja njoftojnë njësinë përgjegjëse në Bankën e Shqipërisë që kryen këtë funksion.
6. DTI-ja dhe DSPKF-ja konsultohen me njësinë përgjegjëse në Bankën e Shqipërisë që kryen funksionin e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë për të shqyrtuar ndikimet e mundshme që mund të kenë ndryshimet në lidhje me përputhshmërinë e sistemeve me parimet mbikëqyrëse.

KREU V **VEPRIMTARIA OPERACIONALE NË AECH**

Neni 15 **Hapja e ditës së punës**

1. DTI-ja kujdeset për të gjithë komponentët e infrastrukturës teknike për të garantuar disponueshmërinë e sistemit AECH gjatë gjithë kohës së operimit.

2. Hapja e ditës së punës në sistemin AECH mund të realizohet në formë automatike ose me ndërveprim të përdoruesit (manuale). DSPKF-ja vlerëson formën më të përshtatshme për realizimin e hapjes së ditës së punës dhe konfiguron sistemin në njërin prej dy formave, e cila mbahet e pandryshuar deri në një vlerësim të ndryshëm nga ky i fundit.
3. Nëse forma e hapjes së ditës së punës në sistemin AECH është automatike, atëherë DSPKF-ja monitoron në çdo orar hapjeje të ditës së punës, statusin e realizimit të këtij procesi në sistemin AECH.
4. Nëse forma e hapjes së ditës së punës në sistemin AECH është manuale, atëherë DSPKF-ja, në përputhje me oraret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, ekzekuton procesin e hapjes së ditës së punës në sistemin AECH dhe monitoron ecurinë dhe statusin e realizimit të këtij procesi.

Neni 16

Mbyllja e ditës së punës

1. Mbyllja e ditës së punës në sistemin AECH mund të realizohet ose në formë automatike, ose me ndërveprim të përdoruesit (manuale). DSPKF-ja vlerëson formën më të përshtatshme për realizimin e mbylljes së ditës së punës dhe konfiguron sistemin në njërin prej dy formave, e cila mbahet e pandryshuar deri në një vlerësim të ndryshëm nga ky i fundit.
2. Nëse forma e mbylljes së ditës së punës në sistemin AECH është automatike, atëherë DSPKF-ja monitoron në çdo orar mbylljeje të ditës së punës, statusin e realizimit të këtij procesi në sistemin AECH.
3. Nëse forma e mbylljes së ditës së punës në sistemin AECH është manuale, atëherë DSPKF-ja, në përputhje me oraret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, ekzekuton procesin e mbylljes së ditës së punës në sistemin AECH dhe monitoron ecurinë dhe statusin e realizimit të këtij procesi.
4. DTI kujdeset për realizimin e procedurave teknike të përcaktuara në funksion të vazhdimësisë së biznesit për sistemin AECH.

Neni 17

Monitorimi i sistemit

Monitorimi i sistemit AECH kryhet bashkërisht nga DSPKF-ja dhe DTI-ja.

1. DSPKF-ja monitoron gjendjen e sistemit gjatë gjithë ditës së punës dhe në veçanti:
 - a) hapjen dhe mbylljen e ditës së punës;
 - b) klerimin e instruksioneve të pagesave në sistem;
 - c) ekzekutimin e seancave të klerimit;
 - d) shlyerjen e rezultatit të klerimit në sistemin AIPS në oraret e përcaktuara;
 - e) statusin e instruksioneve të pagesave në sistem.
2. DTI-ja monitoron gjendjen teknike të sistemit AECH gjatë gjithë ditës së punës dhe në veçanti:
 - a) hapjen dhe mbylljen e ditës së punës;

- b) gjendjen e shërbimeve në funksion të sistemit AECH;
 - c) gjendjen e infrastrukturës që ofron shërbimin e AECH ndaj pjesëmarrësve;
 - d) gjurmët e aktivitetit të sistemit në drejtim të evidentimit të problematikave të mundshme.
3. DSPKF-ja ndjek rastet me pasaktësi në instruksionet e pagesave të iniciuara dhe/ose të mbërritura në favor të Bankës së Shqipërisë.
 4. Në rast se DSPKF-ja, gjatë monitorimit të aktivitetit ditor, vë re anomali në funksionimin e sistemit, menjëherë njofton DTL-në me e-mail ose mjete të tjera komunikimi.
 5. Në rast se DTL-ja, gjatë monitorimit të aktivitetit ditor të sistemeve që administron, vë re anomali të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndikojnë elemente të mirëfunksionimit të sistemit AECH, menjëherë njofton me e-mail DSPKF-në.

Neni 18

Veprimet e Bankës së Shqipërisë si pjesëmarrëse e sistemit AECH

1. Veprimet e iniciuara nga Banka e Shqipërisë si pjesëmarrëse e sistemit AECH përfshijnë:
 - a) instruksione të pagesave të gjeneruara automatikisht në sistemin AECH nga ndërfaqësimi me sistemin e financës së Bankës së Shqipërisë;
 - b) instruksione të pagesave të regjistruara nga DSPKF-ja me urdhër të njësisë së financës së Bankës së Shqipërisë, në rastet kur këto instruksione nuk mund të gjenerohen automatikisht në sistemin AECH.
2. Krahas veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ekzekutohen edhe veprimet e mbërritura në sistemin AECH nga pjesëmarrësit në favor të Bankës së Shqipërisë.
3. DSPKF ndjek ecurinë e plotë të procesimit të instruksioneve të pagesave të iniciuara nga Banka e Shqipërisë dhe të mbërritura në favor të saj, që përfshin:
 - a) transmetimin e instruksioneve të pagesave në sistemin AECH;
 - b) ekzekutimin e seancës së klerimit dhe shlyerjen e instruksioneve të pagesave;
 - c) dokumentimin e veprimeve në llogaritë përkatëse.

Neni 19

Veprimet për Ministrinë

Në zbatim të rolit të Bankës së Shqipërisë bazuar në marrëveshjen e posaçme të lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë:

1. DTL-ja është përgjegjës për:
 - a) mbarëvajtjen e infrastrukturës dhe proceseve teknike të lidhura me Ministrinë në funksion të sistemit AECH;
 - b) integritetin e transmetimit të informacionit në infrastrukturën për të cilën është përgjegjëse Banka e Shqipërisë;
 - c) dërgimin e raporteve elektronike të gjeneruara nga sistemi AECH drejt Ministrisë.
2. DSPKF-ja është përgjegjës për:

- a) procesimin e instruksioneve të pagesave të Ministrisë në sistemin AECH;
- b) ndjekjen e procesit të klerimit të instruksioneve të pagesave të Ministrisë në sistemin AECH;
- c) ndjekjen e procesit të shlyerjes së instruksioneve të pagesave të Ministrisë, të cilat janë kleruar në sistemin AECH.

KREU VI NGJARJET E PAPANASHIKUARA DHE SITUATAT E EMERGJENCËS

Neni 20

Administrimi i ngjarjeve të paparashikuara dhe situatave të emergjencës

1. Ngjarje e paparashikuar, në kuptimin e sistemit AECH, konsiderohet çdo mosfunksionim në:
 - a) infrastrukturën e sistemit AECH;
 - b) komponentë të infrastrukturës IT që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në mirëfunksionimin e sistemit AECH.
2. Situatë emergjence, në kuptimin e sistemit AECH, konsiderohet çdo ndërprerje e rëndësishme e funksionimit të shërbimit të sistemit AECH.
3. Shpallja e situatës së emergjencës kryhet nga DSPKF-ja dhe DTI-ja, në bashkëpunim.
4. Ngjarjet e paparashikuara dhe situatat e emergjencës administrohen nga DTI-ja dhe DSPKF-ja, në bashkëpunim dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
5. Në çdo rast kur DTI-ja konstaton një ngjarje të paparashikuar apo situatë emergjence në kuptimin e sistemit AECH, njofton menjëherë DSPKF-në.
6. Në çdo rast kur DSPKF-ja konstaton një mosfunksionim në sistemin AECH, njofton menjëherë DTI-në.
7. Menjëherë pas konstatimit të një ngjarjeje të paparashikuar apo të një situatë emergjence në kuptimin e sistemit AECH, DTI-ja merr masa për zgjidhjen e saj.
8. DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë për formulimin e njoftimit për pjesëmarrësit në rast se do të jetë e nevojshme.
9. Në rast se brenda 30 minutave nga konstatimi i ngjarjes së paparashikuar apo situatës së emergjencës, problematika nuk është zgjidhur dhe mosfunksionimi ndikon operacionet e pjesëmarrësve në sistemin AECH, DSPKF-ja dërgon me mesazh SWIFT dhe/ose e-mail njoftimin për pjesëmarrësit e sistemit sipas formulimit të përbashkët me DTI-në.
10. Në rast se për shkak të ngjarjes së paparashikuar apo situatës së emergjencës, rivënia në punë e sistemit AECH primar është e pamundur, DTI-ja realizon procedurat për kalimin në sistemin *backup*.
11. DTI në bashkëpunim me DSPKF-ja udhëzon pjesëmarrësit për hapat që duhet të ndjekin për kalimin në sistemin *backup* dhe vazhdimin

- e veprimeve operacionale.
12. Me rikthimin e situatës në normalitet dhe kalimin në sistemin AECH primar, gjithashtu DTI-ja, në bashkëpunim me DSPKF-në, udhëzon pjesëmarrësit.
 13. Menjëherë pas zgjidhjes së situatës, DSPKF-ja njofton pjesëmarrësit me mesazh SWIFT dhe/ose e-mail.
 14. Ngjarjet e paparashikuara dhe situatat e emergjencës të lidhura me sistemin AECH raportohen në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Neni 21 Forca madhore

1. Në rastin e situatave që krijohen si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme, luftërave, turbullirave të tjera civile, fatkeqësive natyrore dhe për çdo rrethanë tjetër jashtë kontrollit të Bankës së Shqipërisë si operator i sistemit dhe pjesëmarrësve në sistem, si dhe si pasojë e çdo force tjetër madhore, drejtuesit e DTI-së dhe DSPKF-së, kur është e mundur, vendosin për ndërprerjen e menjëhershme të operimit të sistemit AECH, me qëllim mbrojtjen e pajisjeve, të dhënave, si dhe komponentëve të tjerë mbështetës të tij.
2. Me përfundimin e ngjarjeve që përbëjnë forcë madhore, DTI-ja dhe DSPKF-ja ndërmarrin hapat e nevojshëm për rifillimin e operimit të sistemit AECH, duke monitoruar dhe duke kontrolluar në mënyrë të hollësishme transaksionet në sistemin AECH.
3. DTI-ja dhe DSPKF-ja kryejnë analiza mbi aktivitetin dhe mbi bashkëveprimin e njësive të Bankës së Shqipërisë gjatë rasteve të forcave madhore, si dhe mbi përpjekjet e bëra për të mundësuar kthimin e aktivitetit operacional në sistem. Kur shihet e nevojshme, propozohen masa për përmirësime të procedurave dhe/ose të konfigurimeve të sistemeve dhe pajisjeve.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22 Organizimi i brendshëm

1. Organizimi i brendshëm i punës brenda njësive organizative të Bankës së Shqipërisë të përmendura në këtë rregullore, për ushtrimin e funksioneve dhe zbatimin e detyrave të përcaktuara nga dispozitat e kësaj rregulloreje, përcaktohet nëpërmjet manualeve përkatëse të veprimtarisë për çdo njësi organizative përbërëse, si dhe në përshkrimet e vendeve të punës së punonjësve.
2. Manualët dhe përshkrimet e vendeve të punës të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, hartohen në përputhje me manualët e përdorimit të sistemit AECH dhe me dispozitat e rregulloreve të organizimit dhe funksionimit të departamenteve përkatëse.

3. Matrica e korrespondencës së funksionaliteteve të sistemit AECH, të cilët i përkasin roleve të përcaktuara për dhënien e aksesit përdoruesve në funksion të kryerjes së detyrave të tyre operacionale në sistemin AECH, miratohet nga drejtuesit e DTI-së dhe DSPKF-së.
4. Kalendari i anëtarësimit të pjesëmarrësit në sistemin AECH është subjekt i veçantive që lidhen me ndryshimet teknologjike dhe përditësimet e herëpashershme, të cilave u nënshtrohet sistemi AECH, dhe hartohet rast pas rasti nga DSPKF-ja dhe DTI-ja, në bashkëpunim, si dhe miratohet nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së.

Neni 23 **Hyrja në fuqi**

Rregullorja hyn në fuqi pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO



SHTOJCA A
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE DHE I KONTABILITETIT DHE FINANCËS

KËRKESË PËR APROVIM PROFILI PËRDORUESI NË AECH

Drejtori i

Departamentit kërkues

(_____)

Tiranë, më

____/____/____

Departamenti:	_____
Sektori:	_____

Drejtori i DSPKF

(_____)

Punonjësit: _____ me detyrë: _____ t'i jepen të drejtat si më poshtë:

Nr.	Aplikacioni AECH	Përdorues	Nr.	Aplikacioni PO	Përdorues
1	Aprovues Execute AECH	<input type="checkbox"/>	1	Operator AECH	<input type="checkbox"/>
2	Operator Execute AECH	<input type="checkbox"/>	2	Aprovues AECH	<input type="checkbox"/>
3	Operator AECH	<input type="checkbox"/>	3	Operator Enter (AIPS & AECH)	<input type="checkbox"/>
4	Back Office Export	<input type="checkbox"/>	4	Operator Approve (AIPS & AECH)	<input type="checkbox"/>
5	Operator Back Office	<input type="checkbox"/>	5	Operator MF	<input type="checkbox"/>
6	Monitorues	<input type="checkbox"/>	6	Aprovues MF	<input type="checkbox"/>
7	Monitorues MF	<input type="checkbox"/>	7	BOA_Security_Officer	<input type="checkbox"/>
8	BOA_Security_Officer	<input type="checkbox"/>			

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit		Drejtori i DTI	
Punonjësi	_____	(Emri Mbiemri / Nënshkrimi)	
Username	_____	Data	Nënshkrimi (Firma)
Krijoi	_____	_____	
Kontrolloi	_____	_____	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 48, datë 3.9.2025

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT SWIFT NË BANKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të neneve 21, 22 dhe 43, shkronja “f” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 129, pikat 1 dhe 6 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe me propozim të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për funksionimin e sistemit SWIFT në Bankën e Shqipërisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Operacioneve Monetare dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit me zbatimin e këtij vendimi.
3. Me miratimin e këtij vendimi shfuqizohet vendimi nr. 30, datë 2.6.2021 i Këshillit Mbikëqyrës “Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e sistemit SWIFT në Bankën e Shqipërisë”.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i funksioneve dhe përgjegjësisë të njësisë organizative të Bankës së Shqipërisë në lidhje me sistemin SWIFT, si dhe i rregullave dhe procedurave për administrimin, operimin, monitorimin dhe kontrollin e këtij sistemi.

Neni 2 Baza juridike

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe në zbatim të:

- a) Ligjit "Për Bankën e Shqipërisë";
- b) Ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
- c) Rregullores "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS";
- d) Rregullores "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH";
- e) Rregullores "Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)";
- f) Politikës së Sigurisë së Informacionit;
- g) Rregullores së Sigurisë së Informacionit;
- h) Akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 3 Fusha e zbatimit

Subjekte të zbatimit të kësaj rregulloreje janë njësitë organizative të mëposhtme të Bankës së Shqipërisë:

- a) Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës;
- b) Departamenti i Operacioneve Monetare;
- c) Departamenti i Teknologjisë së Informacionit.

Neni 4 Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- 1) AECH (*Albanian Electronic Clearing House*) – është sistemi elektronik i klerimit të instruksioneve të pagesave me vlerë të vogël në monedhën kombëtare Lek brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, që mundëson:

- a) shkëmbimin e instruksioneve të pagesave midis pjesëmarrësve,
- b) llogaritjen e pozicioneve shumëpalëshe neto,
- c) dërgimin e një instruksion shlyerjeje neto në sistemin AIPS;

- 2) AFISaR (*Albanian Financial Instrument Settlement and Registration*) – është sistemi qendror i shlyerjes dhe regjistrimit të titujve shtetërorë,

- për të cilët Banka e Shqipërisë organizon ankandet në zbatim të Marrëveshjes me Ministrinë e Financave;
- 3) AIPS (*Albanian Interbank Payment System*) – për qëllime të kësaj rregulloreje do të nënkuptojë Sistemin AIPS të shlyerjes bruto në kohë reale të urdhërpagesave në Lekë, me rëndësi sistemike, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar dhe Sistemin AIPS EURO të shlyerjes bruto në kohë reale të urdhërpagesave ndërbankare të klientëve në monedhën Euro, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar;
 - 4) Autorizim – është një marrëveshje ndërmjet palëve (Bankës së Shqipërisë dhe korrespondentëve) në një marrëdhënie biznesi, për të siguruar leje për dërgimin e mesazheve në një shërbim të caktuar nëpërmjet sistemit SWIFT;
 - 5) AWP-SE (*Alliance Web Platform Server-Embedded*) – është software ndërfaqesh përdoruesish grafikë për të gjitha produktet Alliance, i cili u jep përdoruesve akses nëpërmjet browser-it në funksionalitetet e SAG dhe SAA;
 - 6) *Basic Tracker* – është një ndërfaqe grafike, që u mundëson përdoruesve të implementojnë në një mënyrë të përshtatshme rregullat e biznesit për *Universal Confirmations (UC)*;
 - 7) BSH – është Banka e Shqipërisë;
 - 8) CSP (*Customer Security Programme*) – është programi që kompania SWIFT ka ngritur për të ndihmuar komunitetin e përdoruesve të shërbimeve të saj, në mënyrë që të përmirësojnë sigurinë kibernetike dhe të lehtësojnë vlerësimin e rrezikut kibernetik në mënyrë direkte ndërmjet përdoruesve. CSP përfshin iniciativa si ato të vendosura në *SWIFT Customer Security Controls Framework (CSCF)*, *SWIFT Customer Security Controls Policy (CSCP)*, *Independent Assessment Framework* apo *SWIFT ISAC*;
 - 9) Destinacion – është identiteti i një institucioni përdorues të shërbimeve të kompanisë SWIFT në një vendndodhje të caktuar. Kodi BIC 8-karaktersh identifikon një destinacion;
 - 10) DKn – është Departamenti i Kontrollit;
 - 11) DOM – është Departamenti i Operacioneve Monetare;
 - 12) DSPKF – është Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës;
 - 13) DTI – është Departamenti i Teknologjisë së Informacionit;
 - 14) *Fallback/Disaster Recovery* – është procedura e kthimit të sistemit SWIFT në një situatë normale, pasi ka pasur një dështim të funksionimit të pajisjeve apo sistemit primar dhe/apo *backup*, apo për qëllime testimi;
 - 15) *File* - është njësia që transmetohet ndërmjet pjesëmarrësve të sistemit AECH dhe BSH-së, si edhe ndërmjet Ministrisë së Financave dhe BSH-së në sistemin AIPS, duke përdorur shërbimin *SWIFTNet FileAct*;
 - 16) *InFoRex-LORO* është sistemi i përbërë nga moduli Inforex i administrimit të thesarit, dhe moduli Loro i Administrimit të llogarive të të tretëve;

- 17) ISO 20022 – është standard ndërkombëtar për shkëmbim të dhënash elektronike ndërmjet institucioneve financiare. Ai përshkruan një platformë të përbashkët të përdorur nga industria financiare për të krijuar mesazhe për qëllime të fushës së biznesit financiar;
- 18) Kod BIC (*Business Identifier Code*) – është një standard ndërkombëtar për identifikimin e institucioneve në industrinë e shërbimeve financiare. Kodi BIC mund të jetë 8-karaktersh ose 11-karaktersh dhe standardi ISO 9362 specifikon elementet dhe strukturën e tij;
- 19) Korrespondentë – janë institucionet financiare me të cilat BSH-ja komunikon nëpërmjet sistemit SWIFT;
- 20) KYCSA (*Know Your Customer Security Attestation Application*) – është aplikacion online, si pjesë e portalit www.swift.com, i dizenuar për përdoruesit e SWIFT për të paraqitur të dhënat e vetëvlerësimeve, të cilat konfirmojnë nivelin e pajtueshmërisë së kontrolleve të sigurisë së institucionit të tyre në raport me përcaktimet e *SWIFT Customer Security Controls Framework*. KYCSA ndihmon në rritjen e transparencës në komunitet, duke u mundësuar përdoruesve të ndajnë të dhënat e tyre nga vetëvlerësimi me kundërpalë, si edhe të kërkojnë të dhënat nga kundërpalët, në mënyrë që të lehtësojnë vendimmarrjen bazuar në nivelin e rrezikut për sa i përket marrëdhënieve të tyre të biznesit;
- 21) Mesazh MT – është tip mesazhi tradicional i formatit FIN i përdorur në *network-un* e SWIFT;
- 22) Mesazh MX – është tip mesazhi i formatit XML (standardi ISO 20022) i përdorur në *network-un* e SWIFT;
- 23) Ndërfaqe – janë produkte *software*, të cilat realizojnë bashkëveprimin ndërmjet sistemit SWIFT dhe sistemeve të tjera të BSH-së;
- 24) OF (*Oracle Financial*) – është sistemi kontabël i BSH-së;
- 25) Partneri i rrjetit – është një ofrues rrjeti i pavarur, i cili i mundëson BSH-së, lidhjen me rrjetin SIPN të kompanisë SWIFT;
- 26) PAT2 (*Portfolio Analytics Tool 2*) – është sistemi për administrimin e rezervës valutore;
- 27) Përdorues – janë institucionet/subjektet financiare, si dhe punonjësit e njësive organizative të BSH-së, të autorizuar për të përdorur një apo më shumë shërbime të SWIFT;
- 28) Profil i përdoruesit – është bashkësia e të drejtave që një përdorues ka në sistem, në funksion të detyrave të tij;
- 29) RMA (*Relationship Management Application*) - është një filtër, i cili i mundëson BSH-së një mekanizëm kontrolli në mënyrë që të limitojë korrespondentët me të cilët mund të shkëmbejë mesazhe, si edhe llojet e mesazheve. Përdorimi i mekanizmit RMA është i detyrueshëm për shërbimet FIN dhe FINplus;
- 30) SAA (*SWIFT Alliance Access*) – është aplikacion që shërben si ndërfaqja kryesore e mesazheve të SWIFT-it, e projektuar për të lidhur aplikacionet e biznesit të klientëve të vet me shërbimet e mesazheve të SWIFT-it. Alliance Access është një ndërfaqe shumëplatformëshe që u mundëson klientëve të lidhen me SWIFT nëpërmjet një ose më shumë destinacioneve, me automatizim maksimal të detyrave të menaxhimit të sistemit;

- 31) SAG (*SWIFT Alliance Gateway*) – është një aplikacion që instalohet mbi SNL, i cili mundëson komunikimin aplikacion me aplikacion dhe ka rol në lidhjen me SIPN;
- 32) *Shared Security Officer* (SSO) – është rol me funksionalitet online dhe/ose offline për administrimin e certifikatave dhe roleve të tyre në infrastrukturën PKI të BSH-së për sistemin SWIFT;
- 33) SIPN (*Secure IP network*) – është rrjet privat virtual ndërkombëtar i kompanisë SWIFT, shumë i sigurt dhe i besueshëm;
- 34) Sistemi SWIFT – është sistem në BSH, i cili mundëson komunikimin financiar ndërbankar të BSH-së me korrespondentët e saj dhe përbëhet nga tërësia e komponentëve të kompanisë SWIFT si SIPN, SAA (*SWIFT Alliance Access*), SAG (*SWIFT Alliance Gateway*), SNL (*SWIFTNet Link*), AWP-SE (*WebPlatform Server-Embedded*), SWIFT WebAccess, si edhe *routers*, VPN (*Virtual Private Network*), HSM (*Hardware Security Module*) dhe serverët përkatës. Komponentë të tjerë të këtij sistemi ku BSH-ja ka akses, por që nuk janë të lokalizuar në BSH, janë portali *www.swift.com*, *SWIFTNet Online Operations Manager*, portali RMA dhe *Basic Tracker*. Sistemi SWIFT përfshin ambientin Primar, *Backup* dhe *Disaster*;
- 35) SNL (*SWIFTNet Link*) – është një aplikacion në infrastrukturën e sistemit SWIFT që shërben për aksesimin dhe përdorimin e shërbimeve të mesazheve në *SWIFTNet*, si *FIN*, *InterAct*, *FileAct*, SWIFT WebAccess etj., si dhe për infrastrukturën e çelësve publikë të *SWIFTNet* (*SWIFTNet Public Key Infrastructure*);
- 36) SWIFT (*Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication*) - është Shoqëria për Telekomunikimin Financiar Ndërbankar Botëror, me seli në Belgjikë, me të cilën BSH-ja ka lidhur një kontratë për sigurimin e platformës së komunikimit, të produkteve dhe shërbimeve që i lejojnë BSH-së dhe klientëve të tjerë lidhjen dhe shkëmbimin e informacioneve financiare në mënyrë të sigurt dhe të besueshme, si dhe u mundëson atyre automatizimin dhe standardizimin e transaksioneve financiare;
- 37) *SWIFT Support* – është shërbimi i suportit për BSH-në nga kompania SWIFT;
- 38) *SWIFT Alliance LSO/RSO* (*Left/Right Security Officer*) – janë përkatësisht oficeri i majtë dhe oficeri i djathtë i sigurisë në aplikacionin SAA;
- 39) *SWIFTNet* – është platformë e avancuar e mesazheve të SWIFT e bazuar në IP. *SWIFTNet* përbëhet nga shërbime dhe produkte, të cilat u mundësojnë klientëve të shkëmbejnë informacione financiare kritike dhe të dhëna të transaksioneve në mënyrë të sigurt dhe të besueshme;
- 40) *SWIFTNet FileAct* – është një shërbim mesazhesh i automatizuar që SWIFT ofron për t'u mundësuar klientëve të shkëmbejnë file dhe përdoret për funksionimin e sistemit AECH; Ky shërbim mund të jetë SnF (*Store-and-Forward*) ose RT (*Real Time*). *SWIFTNet FileAct SnF*, ku BSH-ja është administrator i shërbimit, quhet *boa.aech*;
- 41) *SWIFTNet FileAct CUG* (*Closed User Group*) – është një bashkësi subjektsh përdorues të grupuar me qëllim përdorimin e shërbimit

- boa.aech*;
- 42) SWIFTNet FIN – është shërbim shkëmbimi mesazhesh MT në mënyrë të sigurt dhe store-and-forward;
 - 43) SWIFTNet FINplus – është shërbim shkëmbimi mesazhesh interaktiv shumë-me-shumë store-and-forward. FINplus u mundëson institucioneve financiare të shkëmbejnë mesazhe ISO 20022 në mënyrë të sigurt dhe të besueshme;
 - 44) SWIFTNet InterAct – është shërbim mesazhesh, i cili mundëson shkëmbimin interaktiv të mesazheve ndërmjet palëve në mënyrë RT (Real-Time) apo SnF (Store-and-Forward). InterAct është veçanërisht i përshtatshëm për aplikime kritike në lidhje me funksionin dhe kohën;
 - 45) Bank of Albania RTGS AIP ISO20022 (*stan.aip.iso*) – është një shërbim mesazhesh InterAct Y-Copy i ofruar nga kompania SWIFT, i përdorur në funksion të sistemit AIPS, nëpërmjet të cilit instruksionet e pagesës shkëmbehen midis anëtarëve të AIPS CUG;
 - 46) AIPS CUG (Closed User Group) – është grup i mbyllur i pjesëmarrësve të anëtarësuar në SWIFT e të grupuar për qëllim përdorimi të sistemit AIPS.

KREU II FUNKSIONET E DEPARTAMENTEVE NË SISTEMIN SWIFT

Neni 5 Funksionet e DSPKF-së

- DSPKF-ja në sistemin SWIFT ushtron funksionet e mëposhtme:
- a) është përgjegjës për aplikacionin SAA, *Basic Tracker*, portalin RMA dhe destinacionet që ka në përdorim, të cilët janë *STANALTR*, *STANALTA (Live)* dhe *STANALTO*, *ZYAAALTO (test)*;
 - b) është përgjegjës për shërbimet *SWIFTNet InterAct Y-Copy (stan.aip.iso)* dhe *SWIFTNet FileAct SnF (boa.aech)*;
 - c) merr dhe dërgon transaksione financiare në sistemin SWIFT, sipas detyrave funksionale dhe rregullave të sigurisë në fuqi. Transaksionet financiare mund ta kenë burimin/përfundimin në sistemin SWIFT apo në sistemet e ndërfaqësuar me të, si AIPS, AECH, PO, InfoRex-Loro, OF apo PAT2;
 - d) monitoron statusin e mesazheve MT dhe MX të dërguar/marrë dhe siguron që të jenë të kompletuar. Çdo mesazh që do të dërgohet nga destinacionet e aplikacionit SAA, nën përgjegjësinë e DSPKF-së, nuk duhet të qëndrojë më shumë se 2 (dy) ditë pune në pritje për t'u dërguar;
 - e) pas njoftimit nga DOM-i ose nga një korrespondent, kur është e nevojshme, DSPKF-ja shkëmben instruksionet e shlyerjes në funksion të vendosjes/ndryshimit të marrëdhënieve me korrespondentët;
 - f) merr dhe dërgon mesazhe MT ose MX tekst për nevojat e veta ose të njërive të tjera organizative të BSH-së;
 - g) për destinacionet që ka nën përgjegjësi, monitoron dërgimin/marrjen e mesazheve MT dhe MX nga sistemet e ndërfaqësuar me SWIFT, shtypjen e mesazheve MT dhe MX në format letër (për mesazhet

- e përcaktuara për t'u shtypur), si dhe regjistron dhe shpërndan mesazhet që nuk merren nga sistemet e ndërfaqësuar me SWIFT apo që nuk shtypen drejtpërdrejt në njësitë përkatëse të BSH-së;
- h) implementon rregullat e biznesit për *Universal Confirmations* në *Basic Tracker*.

Neni 6 Funksionet e DOM-it

DOM-i në sistemin SWIFT ushtron funksionet e mëposhtme:

- a) është përgjegjës për aplikacionin SAA, për portalin RMA dhe destinacionet që ka në përdorim, të cilët janë STANALTS (Live) dhe ZYACALTO (test);
- b) merr dhe dërgon transaksione financiare në sistemin SWIFT, sipas detyrave funksionale dhe rregullave të sigurisë në fuqi. Transaksionet financiare mund ta kenë burimin/përfundimin në sistemin SWIFT apo në sistemin AFISaR të ndërfaqësuar me të;
- c) monitoron statusin e mesazheve MT të dërguar/marrë prej tyre dhe siguron që të jenë të kompletuar. Çdo mesazh që do të dërgohet nga destinacionet e aplikacionit SAA, nën përgjegjësinë e DOM-it, nuk duhet të qëndrojë më shumë se 2 (dy) ditë pune në pritje për t'u dërguar;
- d) ruan, përditëson dhe shkëmben instruksionet e shlyerjes në funksion të vendosjes së marrëdhënieve me korrespondentë të rinj ose kur BSH ndryshon instruksionet e shlyerjes;
- e) Për destinacionet që ka nën përgjegjësi, monitoron dërgimin/marrjen e mesazheve MT nga sistemi AFISaR i ndërfaqësuar me sistemin SWIFT, dhe monitoron mesazhet që nuk merren nga sistemi AFISaR apo që nuk shtypen drejtpërdrejt në njësitë përkatëse të BSH-së.

Neni 7 Funksionet e DTI-së

DTI-ja, në sistemin SWIFT, ushtron funksionet e mëposhtme:

- a) është kujdestar i sistemit SWIFT;
- b) administron teknikisht sistemin SWIFT;
- c) është përgjegjës i komponentëve të sistemit SWIFT (SIPN, SAG, AWP-SE, WebAccess, SNL, routers, VPN, HSM, serverët përkatës) duke përfshirë aplikacionin SAA dhe destinacionet e tij, si edhe duke përfshirë *Basic Tracker* dhe portalin RMA, siç është përmendur edhe në nenin 5, shkronja "a" dhe nenin 6, shkronja "a";
- d) administron komponentët e sistemit SWIFT, të cilët nuk janë të lokalizuar në BSH, si portali www.swift.com, SWIFTNet Online Operations Manager, portali RMA dhe *Basic Tracker*, bazuar në të drejtat që i lejohen nga kompania SWIFT;
- e) siguron mirëfunksionimin e sistemit SWIFT;
- f) realizon përditësimin e sistemit SWIFT në përputhje me standardet e mesazheve dhe të sigurisë në sistemin SWIFT dhe administron ndryshimet në këtë sistem;

- g) realizon konfigurimin e ndërfaqeve të sistemit SWIFT me sistemet e brendshme, në bashkëpunim me departamentet përgjegjëse të tyre;
- h) përcakton konfigurimin e lidhjes me rrjetin SIPN dhe sigurohet për mirëfunksionimin e tij;
- i) siguron mirëfunksionimin e komponentëve të sistemit SWIFT me njëri-tjetrin, me rrjetin SIPN, me ndërfaqet e sistemit SWIFT dhe me sistemet e tjera të brendshme në BSH;
- j) është pikë kontakti me kompaninë SWIFT dhe Partnerin e Rrjetit, dhe ndjek zbatimin e kontratave respektive me ta;
- k) zbaton procedurat dhe politikën e sigurisë në sistemin SWIFT, në përputhje me standardet e kompanisë SWIFT;
- l) administron rrezikun dhe aftësinë ripërtëritëse të sistemit SWIFT;
- m) kujdeset për kryerjen e procedurave *Fallback/Disaster-Recovery*;
- n) kujdeset për kryerjen e procedurave të arkivimit dhe *Backup/Restore*;
- o) administron situatat e emergjencës në sistemin SWIFT;
- p) administron profilet e përdoruesve dhe përdoruesit e sistemit SWIFT;
- q) mbështet përdoruesit e BSH-së në përdorimin e sistemit SWIFT;
- r) mban kontakte me përdoruesit (për çështje të pjesëmarrjes në sistemet e pagesave) dhe i mbështet ata në lidhje me përdorimin e shërbimit *stan.aip.iso* dhe *boa.aech*;
- s) ndjek procedurat e hapjes/mbylljes së aplikimeve në sistemin SWIFT. Shërbimet e lidhura me destinacionet *Live* në aplikacionin SAA duhet të jenë hapur gjatë orarit zyrtar në përputhje me nevojat e departamenteve përgjegjëse dhe oraret e sistemeve të ndërfaqësuarra të cituara në rregulloret përkatëse, ku hapja nuk kryhet më herët se fillimi i orarit zyrtar dhe mbyllja nuk është më e vonë se përfundimi i orarit zyrtar. Për nevoja të BSH-së, ndryshimi në oraret e sistemit kryhet pas njohfimit nga departamentet përgjegjëse të shërbimeve/aplikacioneve dhe destinacioneve përkatëse të këtij sistemi.

Neni 8

Funksione të përbashkëta mes DSPKF-së dhe DTI-së

DSPKF-ja dhe DTI-ja, në sistemin SWIFT, ushtrojnë funksione të përbashkëta si më poshtë:

- a) ndjekin procedurat e anëtarësimit të një përdoruesi të ri në shërbimin *stan.aip.iso* dhe/ose në shërbimin *boa.aech*;
- b) administrojnë *AIPS CUG* dhe *SWIFTNet FileAct CUG*.

Neni 9

Funksione të përbashkëta mes DSPKF-së, DOM-it dhe DTI-së

DSPKF-ja, DOM-i dhe DTI-ja, në sistemin SWIFT, ushtrojnë funksione të përbashkëta, si më poshtë:

- a) përcaktojnë tipet e mesazheve *MT*, *MX* apo *file*-ve që do të shkëmbehen me korrespondentët;
- b) hartojnë dhe përcaktojnë procedurat e përpunimit të mesazheve financiare në nisje dhe në mbërritje sipas detyrave funksionale dhe rregullave të sigurisë në fuqi;

- c) hartojnë/përcaktojnë formularin që duhet të përdoret për procesin e miratimit të përdoruesve në aplikacionin SAA;
- d) përcaktojnë profilet e përdoruesve dhe përdoruesit e aplikacionit SAA, sipas destinacioneve përkatëse;
- e) bashkëpunojnë sipas përkatësisë për përmbushjen e pikave të detyrueshme të CSP;
- f) shpallin dhe administrojnë situatat e emergjencës në sistemin SWIFT. DTI-ja njofton DSPKF-në dhe DOM-in për situatën e emergjencës. DSPKF-ja dhe DOM-i lajmërojnë korrespondentët për situatën e emergjencës sipas nevojës dhe përkatësisë.

KREU III **ADMINISTRIMI I SISTEMIT SWIFT**

Neni 10

Miratuesit e Autorizuar të shërbimeve *stan.aip.iso* dhe *boa.aech*

1. BSH-ja, në lidhje me shërbimet *SWIFTNet InterAct Y-Copy (stan.aip.iso)* dhe *SWIFTNet FileAct SnF (boa.aech)*, përfaqësohet kundrejt kompanisë SWIFT nga Miratuesit e Autorizuar.
2. Miratuesit e Autorizuar mbajnë rolin "Service approver" në portalin *www.swift.com*.
3. Miratuesit e Autorizuar administrojnë marrëdhëniet me korrespondentët brenda *Closed User Groups* për shërbimet *stan.aip.iso* dhe *boa.aech*, duke pranuar apo përjashtuar pjesëmarrës.
4. Miratues të Autorizuar të BSH-së, janë Drejtori i DSPKF-së dhe Drejtori i DTI-së.
5. Miratuesit e Autorizuar janë përgjegjës dhe komunikojnë me kompaninë SWIFT në lidhje me detyrat e përcaktuara në kontratat e lidhura për shërbimet *stan.aip.iso* dhe *boa.aech*.

Neni 11

Administrimi i marrëdhënieve me korrespondentët nëpërmjet RMA-së

1. Për marrëdhëniet me korrespondentët për shërbimet *SWIFTNet FIN* dhe *SWIFTNet FINplus*, përdoret RMA-ja.
2. DTI-ja kryen administrimin e portalit RMA.
3. BSH-ja autorizon nëpërmjet RMA-së një korrespondent për të marrë transaksione financiare prej tij në këtë mënyrë:
 - a) DOM-i (për destinacionin STANALTS) ose DSPKF-ja (për destinacionin STANALTR) paraqet kërkesën e tij me shkrim tek DTI-ja;
 - b) DTI-ja, sipas kërkesës, krijon dhe aktivizon "autorizimin për të marrë" në RMA, me tipet e profileve të përzgjedhura nga DOM-i ose DSPKF-ja sipas përkatësisë, për korrespondentin e kërkuar nga destinacioni përkatës.
4. Korrespondenti autorizon BSH-në nëpërmjet RMA-së për të dërguar transaksione financiare në adresë të tij në këtë mënyrë:
 - a) Korrespondenti dërgon një "autorizim për të dërguar" me tipet e profileve të përzgjedhura prej tij drejtuar BSH-së për një destinacion të caktuar;
 - b) DTI-ja paraqet këtë "autorizim për të dërguar" tek DOM-i ose DSPKF-

- ja për konfirmim, sipas destinacioneve që kanë nën përgjegjësi;
- c) DTI-ja ekzekuton konfirmimin ose refuzimin e marrë përkatësisht nga DOM-i ose DSPKF-ja për këtë autorizim. Në çdo rast, paraqitja, konfirmimi dhe ekzekutimi i konfirmimit apo refuzimit, duhet të kryhen brenda 6 (gjashtë) ditëve pune.
 5. Në rast se BSH-ja merr një "autorizim për të dërguar", për të cilin korrespondenti kërkon një autorizim ekuivalent (për të lejuar trafikun në të dy drejtimet), atëherë BSH duhet ta dërgojë këtë autorizim ekuivalent brenda 6 (gjashtë) ditëve pune duke zbatuar hapat e përcaktuar në pikat 3 dhe 4 të këtij neni.
 6. BSH-ja vendos të mos dërgojë dhe/ose marrë transaksione financiare për dhe/ose nga një korrespondent, nga një destinacion i caktuar, duke fshirë "autorizimin për të dërguar" dhe/ose revokuar "autorizimin për të marrë" përkatës në këtë mënyrë:
 - a) Departamenti përgjegjës i një destinacioni paraqet kërkesën e tij me shkrim tek DTI-ja;
 - b) DTI-ja sipas kërkesës kryen fshirjen e "autorizimit për të dërguar" dhe/ose revokimin e "autorizimit për të marrë" për korrespondentin e kërkuar nga destinacioni përkatës.
 7. Në rast se një korrespondent vendos të mos dërgojë dhe/ose marrë më transaksione financiare për dhe/ose nga BSH-ja, nga një destinacion i caktuar, duke fshirë dhe/ose revokuar autorizimin përkatës, ndiqen hapat e mëposhtëm:
 - a) DTI-ja kryen konfirmimin e statusit të refuzimit të "autorizimit për të marrë" përkatës brenda 6 (gjashtë) ditëve pune. Ky konfirmim ka vetëm qëllim informues;
 - b) DTI-ja njofton me shkrim departamentin përgjegjës të destinacionit;
 - c) DTI-ja kryen konfirmimin e statusit të revokimit të "autorizimit për të dërguar" për destinacionin përkatës, sa më shpejt të jetë e mundur, pas miratimit me shkrim nga departamenti përgjegjës, por jo më vonë se brenda 2 (dy) ditëve pune.
 8. BSH-ja dhe anëtarët e *AIPS CUG* dhe *SWIFTNet FileAct SnF CUG* nuk shkëmbejnë autorizime RMA ndërmjet tyre, në lidhje me shkëmbimin e transaksioneve financiare në shërbimet *stan.aip.iso* dhe *boa.aech*.

Neni 12

CSP (*Customer Security Programme*)

1. Vetëdeklarimi CSP:
 - a) DTI-ja, në bashkëpunim me DSPKF-në dhe DOM-in, angazhohen për përmbushjen e pikave të programit CSP, të publikuara nga kompania SWIFT në baza vjetore dhe njoftojnë DKn-në për realizimin e tyre;
 - b) DKn-ja bazuar në kërkesat rregullatore të SWIFT, jep siguri të arsyeshme mbi përmbushjen e pikave të detyrueshme të CSP;
 - c) DTI-ja kujdeset për deklarimin e të dhënave në KYCSA brenda afateve të përcaktuara nga SWIFT, duke ndjekur parimin e katër syve.
2. DOM-i dhe DSPKF-ja bëjnë kërkesë pranë DTI-së për caktimin e roleve në KYCSA për punonjësit, për secilin destinacion, sipas përgjegjësisë, lidhur me administrimin e shkëmbimit të informacionit në kuadër të CSP.

3. DOM-i dhe DSPKF-ja mund të lejojnë dhënien e informacionit mbi CSP në kundërpalë, si edhe mund të kërkojnë informacion të kundërpalëve lidhur me zbatimin e CSP nga ana e tyre, sipas nevojave të departamenteve përkatëse, në kuadër të menaxhimit të marrëdhënieve me kundërpalët.

Neni 13

Administrimi i përdoruesve të BSH-së në sistemin SWIFT

DTI-ja kryen administrimin e përdoruesve të departamenteve të BSH-së në sistemin SWIFT, si më poshtë:

1. Përcakton formularët që duhet të përdoren për procesin e miratimit të përdoruesve, profilet e përdoruesve dhe përdoruesit për aplikacionet dhe komponentët për të cilët është përgjegjës. Formularët e komponentëve *www.swift.com* dhe *SWIFTNet Online Operations Manager* mund të jenë subjekt i ndryshimeve të kompanisë SWIFT pa njoftuar paraprakisht BSH-në. Këto ndryshime nuk varen nga DTI-ja dhe do të përditësohen sipas rastit.
2. Rregullat e administrimit të përdoruesve për komponentët e sistemit SWIFT ku DTI-ja është përgjegjës, përcaktohen në Manualin e veprimeve të DTI-së për funksionimin e sistemit SWIFT.
3. Në lidhje me aplikacionin SAA dhe komponentët Basic Tracker dhe RMA:
 - a) krijon/modifikon përdoruesit, pas plotësimit të formularit përkatës të dakordësuar me departamentet përgjegjëse sipas destinacioneve përkatëse dhe në përputhje me detyrat funksionale të përdoruesve, i cili plotësohet nga departamenti që inicion kërkesën, miratohet nga përgjegjësi për sistemin / aplikacionin / shërbimin / destinacionin dhe më pas nga drejtuesi i DTI-së në rolin e kujdestarit të sistemit SWIFT;
 - b) çaktivizon apo fshin përdoruesit në rast ndryshimi të vendit të punës apo largimi të tyre, me kërkesë të drejtuesit të departamentit përkatës, si edhe me miratimin nga drejtuesi i DTI-së;
 - c) krijon, modifikon apo fshin profilet e përdoruesve, me miratim të drejtuesit të departamentit përgjegjës për sistemin/aplikacionin/shërbimin/ destinacionin dhe më pas të drejtuesit të DTI-së;
 - d) përcakton përdoruesit e DTI-së, të cilët do të kryejnë rolin e SWIFTAlliance LSO dhe SWIFTAlliance RSO për aplikacionin SAA, si edhe Shared Security Officers (SSO) për Basic Tracker dhe RMA dhe kryen zëvendësimin e tyre, me miratimin e drejtuesve të DSPKF-së, DOM-it dhe DTI-së.
4. Profilet e përdoruesve dhe formularët përkatës të sistemit SWIFT miratohen sipas përgjegjësisë nga drejtuesi i DSPKF-së, drejtuesi i DOM-it dhe drejtuesi i DTI-së. Në çdo rast formularët nënshkruhen nga drejtuesi i DTI-së, si kujdestar i sistemit SWIFT.

Neni 14

Situatat e emergjencës në sistemin SWIFT dhe masat që ndërmerren

1. Situatë emergjence në sistemin SWIFT përbën ndërprerja e funksionimit të aplikacionit SAA ose ndërprerja e funksionimit të komponentëve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në mirëfunksionimin e shërbimeve të sistemit SWIFT.

2. Në rast se vërehet një nga situatat e emergjencës, atëherë DTI-ja shpall emergjencën në sistemin SWIFT, informon departamentet përgjegjëse dhe përdoruesit e sistemit, si dhe merr masa për zgjidhjen e kësaj situatë. DSPKF-ja dhe DOM-i njoftojnë korrespondentët në përputhje me aktet në fuqi.
3. Në rast se për shkak të situatës së emergjencës, rivendosja në funksionim e sistemit SWIFT Primar është e pamundur brenda afateve kohore të rëndësishme për proceset e DSPKF-së dhe DOM-it, atëherë DTI-së, pas miratimit nga drejtuesit e departamenteve përgjegjëse të sistemit, realizon procedurat për kalimin në sistemin SWIFT *Backup/Disaster*.
4. Përdoruesit e sistemit SWIFT në BSH njoftohen menjëherë nga DTI-ja, ndërsa korrespondentët njoftohen nga DSPKF-ja dhe DOM-i sipas përgjegjësisë, pas zgjidhjes së situatës së emergjencës, me mesazh SWIFT apo e-mail për vazhdimin e operacioneve të ditës së punës.

Neni 15 Forca madhore

1. Forca madhore në kuptim të kësaj rregulloreje janë gjendjet e jashtëzakonshme, luftërat, demonstratat, grevat, turbullira të tjera civile, fatkeqësi natyrore, si dhe çdo rrethanë tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të njeriut, e cila përbën forcë madhore nga praktika.
2. Me shfaqjen e ngjarjeve që përbëjnë forcë madhore dhe që gjykohej se vendosin në rrezik funksionimin normal dhe të sigurt të aktivitetit në sistemin SWIFT, sipas pikës 1 të këtij neni, drejtuesit e DTI-së, DSPKF-së dhe DOM-it vendosin për ndalimin e menjëhershëm të funksionimit të sistemit SWIFT, me qëllim mbrojtjen e pajisjeve, të të dhënave, si dhe të komponentëve të tjerë mbështetës të tij.
3. Me përfundimin e ngjarjeve që përbënin forcë madhore të shoqëruara me ndalim të funksionimit të sistemit SWIFT, DTI-ja, DSPKF-ja dhe DOM-i ndërmarrin hapat e nevojshëm për rifillimin e operimit të sistemit SWIFT, duke monitoruar dhe duke kontrolluar në mënyrë të hollësishme transaksionet e hyra dhe të dërguara në sistemin SWIFT.

Neni 16 Organizimi i brendshëm

1. Organizimi i brendshëm i punës brenda njësisë organizative të BSH-së, të cilat janë të ngarkuara me zbatimin e kësaj rregulloreje, përcaktohet nëpërmjet manualeve të veprimtarisë së këtyre njësisë organizative për sistemin SWIFT, si dhe manualeve të vendeve të punës të punonjësve përkatës.
2. Manualët e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, hartohen në përputhje me manualët e përdorimit të sistemit SWIFT dhe me dispozitat e rregulloreve mbi organizimin dhe funksionimin e departamenteve përkatëse.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 49, datë 3.9.2025

**PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN
"PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE PËR TRANSFERTAT E KREDITIT DHE TË
DEBITIMIT DIREKT NË EURO"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 21 dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 129 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 15, pika 1 të ligjit nr. 133, datë 30.4.2013, "Për sistemin e pagesave"; dhe titujve III, IV dhe V të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave"; me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbiqëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro", miratuar me vendimin e Këshillit Mbiqëqyrës nr. 21, datë 3.4.2024, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në nenin 1, pas pikës 3, shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

"4. Neni 4/1 i kësaj rregulloreje zbatohet për transaksionet e pagesave në Euro midis zonës SEPA dhe Republikës së Shqipërisë, për ato pjesë të pagesave që kryhen në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 55, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave"."
 - b) Në nenin 2, pas pikës 2, shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

"3. Neni 4/1 i kësaj rregulloreje nuk zbatohet për pagesat objekt i rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për funksionimin e sistemit AIPS EURO për shlyerjen e transfertave vendase për klientë në Euro."

- c) Në nenin 3, pika 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. Pas shkronjës "a", shtohet shkronja "a/1" me përmbajtjen e mëposhtme:
"a/1) "anëtar i SEPA-s" është një vend ose territor i përfshirë në zonën SEPA;"
 - ii. Në shkronjën "n", pas fjalisë së parë, shtohet fjalia e mëposhtme me përmbajtje si vijon:
"n) Për qëllime të aplikimit të tarifave sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, termi "pagesë SEPA" është një transaksion elektronik pagese, në Euro, i iniciuar nga një pagues, ose nga/nëpërmjet një përfituesi, ku njëri nga ofruesit e shërbimeve të pagesave të përfshirë në transaksion, qoftë ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ose ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit, ndodhet në Republikën e Shqipërisë dhe ofruesi tjetër i shërbimeve të pagesave ndodhet në një vend ose territor tjetër në zonën SEPA;"
 - iii. Pas shkronjës "n" shtohet shkronja "n/1" me përmbajtjen e mëposhtme:
"n/1 "pagesë kombëtare" është një transaksion pagese i përpunuar elektronikisht i iniciuar nga një pagues, ose nga/nëpërmjet një përfituesi, ku ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit dhe ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit ndodhen të dy në Republikën e Shqipërisë;"
 - iv. Pas shkronjës "w" shtohet shkronja "w/1" me përmbajtjen e mëposhtme:
"w/1) "tarifë" është çdo shumë që i ngarkohet një përdoruesi të shërbimeve të pagesave prej një ofruesi të shërbimeve të pagesave, e cila lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me një transaksion pagese, çdo shumë që i ngarkohet një përdoruesi të shërbimeve të pagesave prej një ofruesi të shërbimeve të pagesave ose prej një pale e cila ofron shërbime të këmbimit të monedhës në përputhje me nenin 52, pikat 2 dhe 3 të ligjit për shërbimet e pagesave, për një shërbim të këmbimit të monedhës, ose një kombinim të tyre;"
 - v. Pas shkronjës "z" shtohet shkronja "z/1" me përmbajtjen e mëposhtme:
"z/1) "transfertë krediti e menjëhershme" është një transfertë krediti që ekzekutohet menjëherë, 24 orë në ditë dhe në çdo ditë kalendarike;"
- d) Pas nenit 4, shtohet neni 4/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Neni 4/1

Tarifat për pagesat SEPA dhe pagesat kombëtare që i korrespondojnë

1. OShP-të mund të aplikojnë tarifa për transfertat e kreditit, transfertat e kreditit të menjëhershme dhe debitimet direkte, hyrëse dhe dalëse SEPA, në përputhje me rregullat përkatëse të skemës SEPA, dhe me metodën e kostove të ndara (SHA), sikurse parashikohet në nenin 55, pika 2 të ligjit "Për shërbimet e pagesave".

2. *Tarifat e aplikuara nga OShP-të për përdoruesit e shërbimeve të pagesave, nuk mund të tejkalojnë kufijtë e mëposhtëm në asnjë rrethanë:*
 - a) *tarifat për pagesat SEPA dalëse nuk mund të tejkalojnë kufijtë e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë për vlerat korresponduese të pagesave kombëtare në Euro që procesohen përmes sistemeve të saj dhe përcaktohen në kuadrin rregullativ të këtyre sistemeve;*
 - b) *tarifat për pagesat SEPA hyrëse, nëse aplikohen nga OShP-të e përfituesit të pagesës, duhet të reflektojnë kostot përkatëse të ofruesit të shërbimeve të pagesave. Këto tarifa, në asnjë rast nuk mund të kalojnë vlerën 3 Euro për transaksion.*
3. *Pikat 1 dhe 2 e këtij neni nuk zbatohen për:*
 - a) *tarifat e këmbimit të monedhës;*
 - b) *transferrat e kreditit të menjëhershme, në rast se legjislacioni i fushës do të kërkojë që një OShP të vendosë një tarifë më të ulët se tarifa që do të vendosej për të njëjtën transfertë krediti të menjëhershme, nëse do të zbatoheshin pikat 1 dhe 2 të këtij neni.*
- e) *Përmbajtja e nenit 5, zëvendësohet me përmbajtjen e mëposhtme:*
 1. *Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose sanksionet të parashikuara në nenin 25 dhe në kreun I të Titullit V (neni 94-95) të ligjit "Për shërbimet e pagesave".*
 2. *Ankimi administrativ dhe gjyqësor kryhet sipas dispozitave të kreut II të Titullit V (neni 96-97) të ligjit "Për shërbimet e pagesave".*
- f) *Pas nenit 8, shtohet neni 9 me përmbajtjen e mëposhtme:*

"Neni 9

Përfundimi i zbatueshmërisë së rregullores

Kjo rregullore do të jetë në fuqi deri në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian."

2. *Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje me zbatimin e këtij vendimi.*
3. *Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.*
4. *Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.*

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 7.10.2025.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 50, datë 3.9.2025

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
"PËR ORGANIZIMIN E EKSPOZITAVE TË PËRKOHSHME TË VLERAVE
NUMIZMATIKE DHE OBJEKTEVE MUZEORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË,
BRENDA DHE JASHTË BANKËS SË SHQIPËRISË"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "f" dhe "g", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të Kreut III, nenit 14, shkronja "b", të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Kërkimeve", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 42, datë 30.3.2016; nenit 29 të rregullores (Statuti) "Për organizimin dhe funksionimin e muzeut të Bankës së Shqipërisë" nr.41, datë 3.6.2015, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Kërkimeve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për organizimin e ekspozitave të përkohshme të vlerave numizmatike dhe objekteve muzeore të Bankës së Shqipërisë, brenda dhe jashtë Bankës së Shqipërisë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Kërkimeve, Departamenti i Administrimit, Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes, dhe Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi dhe të rregullores në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Me miratimin e kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja "Për ekspozimin e vlerave numizmatike dhe administrimin e ruajtjen e tyre nga Banka e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr.40, datë 13.6.2012, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave për organizimin e ekspozitave të përkohshme të fondit numizmatik të Muzeut dhe objekteve muzeore, pjesë e fondit të Muzeut të Bankës së Shqipërisë:
 - a) brenda ambienteve të Bankës së Shqipërisë; dhe
 - b) jashtë ambienteve të Bankës së Shqipërisë (brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj), duke garantuar siguri, integritet dhe dokumentim gjatë planifikimit, organizimit dhe administrimit të këtyre ekspozitave.
2. Përfshihet nga dispozitat e kësaj rregulloreje, ekspozimi i vlerave numizmatike në ambientet e Muzeut të Bankës së Shqipërisë.

Neni 2 Baza ligjore

Zbatimi i kësaj rregullore bëhet në përputhje me kërkesat e akteve të mëposhtme:

- a) ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- b) Statutit të Bankës së Shqipërisë miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 90, datë 2.12.2015, i ndryshuar;
- c) rregullores nr. 42, datë 30.3.2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Kërkimeve".

Neni 3 Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha ekspozitat e përkohshme që përfshijnë vlera numizmatike dhe objekte muzeore të fondit të Muzeut të Bankës së Shqipërisë jashtë mjediseve të tij.

Neni 4 Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje:

1. "Fondi numizmatik i Muzeut" nënkupton monedha, kartëmonedha, medaljon, prova monedhash, modele kartëmonedhash, e të tjera të ngjashme me to, të regjistruara në inventarin e Muzeut të Bankës së Shqipërisë;
2. "Objekte muzeore" nënkupton objektet ose dokumentet, me vlera kulturore e historike, të regjistruara në inventarin e Muzeut të Bankës së Shqipërisë. Këto janë të ndryshme nga "fondi numizmatik i Muzeut" të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni;

3. "Fondi i ekspozitës" nënkupton artikujt e miratuar për ekspozim në ekspozitën e përkohshme, përzgjedhur nga fondi numizmatik i Muzeut dhe objektet muzeore;
4. "Ekspozitë e përkohshme brenda BSH-së" është një ekspozitë që zhvillohet në çdo ambient të brendshëm të Bankës së Shqipërisë që nuk bën pjesë në ekspozitën e përhershme të Muzeut;
5. "Ekspozitë e përkohshme jashtë BSH-së" është një ekspozitë që zhvillohet në ambiente të subjekteve bashkëorganizatore ose të treta, jashtë ndërtesave të Bankës së Shqipërisë, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
6. "Institucioni pritës" është subjekti bashkë organizator jashtë BSH-së ku zhvillohet ekspozita;
7. "Komisioni i Administrimit të Fondit të Ekspozitës" është komisioni i ngarkuar me administrimin e fondit të ekspozitës përgjatë periudhës së organizimit të ekspozitave të përkohshme, brenda dhe jashtë ambienteve të Bankës së Shqipërisë (në vijim, për lehtësi "Komisioni"). Në rastin e ekspozitave të përkohshme jashtë ambienteve të Bankës së Shqipërisë, anëtarët e Komisionit janë pjesë dhe përzgjidhen nga Grupi i Punës;
8. "Grupi i Punës" është grupi i ngarkuar me organizimin e ekspozitave të përkohshme jashtë ambienteve të Bankës së Shqipërisë (në vijim, për lehtësi "GP").

KREU II ADMINISTRIMI I PROCESIT TË EKSPOZIMIT

Neni 5 E drejta për të propozuar

1. Të drejtë për të propozuar organizimin e ekspozitave të përkohshme e kanë:
 - a) Administratorët e Bankës së Shqipërisë;
 - b) Departamenti i Kërkimeve.
2. Në rast kërkesash nga subjekte të treta, publike ose private, drejtuar Bankës së Shqipërisë me propozime për organizimin e ekspozitave të përkohshme, ato shqyrtohen nga Administratori përkatës.

Neni 6 Vendimmarrja për ekspozitën dhe për ekspozimin e fondit të ekspozitës

Vendimi për kryerjen e ekspozitës dhe ekspozimin e fondit të ekspozitës merret si vijon:

- a) nga Këshilli Mbikëqyrës, për kryerjen e ekspozitës dhe ekspozimin e fondit numizmatik të Muzeut që përfshin vlera numizmatike prej ari, platini dhe argjendi;
- b) nga Administratorët, për kryerjen e ekspozitës dhe ekspozimin

e pjesës tjetër të fondit numizmatik të Muzeut, të papërfshira në shkronjën "a" të këtij neni dhe objekteve muzeore.

Neni 7 **Lëvizja e fondit të ekspozitës**

1. Pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës/Administratori, sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje, fondi i ekspozitës lëviz si më poshtë:
 - a) Vlerat numizmatike pjesë e fondit numizmatik të Muzeut të ruajtura në Arkën Stok dorëzohen nga të ngarkuarit me vlera në Arkën Stok (Departamenti i Emisionit) tek ata të Muzeut (Departamenti i Kërkimeve). Të ngarkuarit me vlera në Muze i dorëzojnë ato te Komisioni, i cili merr në ngarkim inventarin e fondit të ekspozitës për të gjithë periudhën/kohëzgjatjen e ekspozitës. Me mbarimin e ekspozitës, vlerat numizmatike kthehen nga Komisioni në Muze dhe Muzeu i kthen në Arkën Stok;
 - b) Fondi i ekspozitës i mbajtur në Muze dorëzohet nga të ngarkuarit me vlera në Muze te Komisioni, i cili merr në ngarkim inventarin e fondit të ekspozitës për periudhën/kohëzgjatjen e ekspozitës. Me mbarimin e ekspozitës, vlerat kthehen nga Komisioni në Muze.

Neni 8 **Dokumentimi i dorëzimit të fondit të ekspozitës**

1. Dorëzimi i fondit të ekspozitës sipas procedurës së parashikuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje, dokumentohet përmes një procesverbali dorëzim–marrjeje, të paraqitur në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje, që përmban:
 - a) periudhat, kodet identifikuese, prerjen, vitin e emetimit;
 - b) titullin/përbërjen dhe peshën (kur aplikohet);
 - c) numrin e objekteve për ekspozim dhe vlerën për njësi;
 - d) fotot e secilit objekt me numrin e inventarit për zërat e fondit të ekspozitës të pa pajisur me pasaportë objekti.
2. Procesverbali i hartuar si në pikën 1 të këtij neni, nënshkruhet nga dorëzuesit dhe marrësit në dorëzim, respektivisht për daljen dhe hyrjen (mbas mbarimit të ekspozitës) të vlerave nga/në arkën/at korresponduese. Procesverbali mbahet në 5 (pesë) kopje, nga të cilat: 1 (një) kopje depozitohet në Zyrën e Arkiv Protokollit, 1 (një) kopje në Departamentin e Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, 1 (një) kopje pranë Departamentit të Kërkimeve, 1 (një) kopje në Zyrën e Muzeut, si dhe 1 (një) kopje te Komisioni.

Neni 9 **Pasqyrimi kontabël i lëvizjes së fondit të ekspozitës dhe inventarizimi**

1. Zyra e Muzeut, në bashkëpunim me Departamentin e Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, pasqyron lëvizjet e vlerave numizmatike në inventarë të veçantë ose në sistemet operationale

- të Bankës së Shqipërisë.
2. Inventarizimi kryhet sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për inventarizimin e vlerave monetare, aktiveve materiale dhe aktiveve jomateriale në Bankën e Shqipërisë".

KREU III

EKSPOZITAT E PËRKOHSHME BRENDA BANKËS SË SHQIPËRISË

Neni 10

Komisioni i Administrimit të fondit të ekspozitës

1. Për çdo ekspozitë të përkohshme brenda ambienteve të Bankës së Shqipërisë, krijohet një Komision i Administrimit të Fondit të Ekspozitës (Komisioni) me jo më pak se 3 punonjës, i ngritur me urdhër të Administratorit përkatës.
2. Komisioni i Administrimit të Fondit të Ekspozitës është përgjegjës për marrjen në ngarkim të inventarit të fondit të ekspozitës, administrimin, hapjen/mbylljen e vitrinave dhe dokumentimin e plotë të lëvizjes së fondit për periudhën/kohëzgjatjen e ekspozitës.

Neni 11

Ambientet e ekspozimit

Ekspozitat zhvillohen vetëm në ambiente të miratuara si zona sigurie nga Banka e Shqipërisë, të cilat garantojnë mbrojtje të vazhdueshme dhe prani të personelit të sigurisë, në përputhje me rregulloret "Për regjimin e Hyrje - Daljeve dhe qëndrimin në ambientet e Bankës së Shqipërisë", "Mbi ndarjen e mjediseve të Bankës së Shqipërisë në zona sigurie dhe masat për mbrojtjen e tyre".

Neni 12

Pajisjet e ekspozimit, kërkesat e sigurisë dhe administrimi i çelësave

1. Fondi i ekspozitës vendoset në pajisje ekspozimi (korniza, stenda, kasa), të mbyllura me çelës dhe me material të fortë (dhe/ose xham të fortë) rezistent ndaj goditjes.
2. Administrimi i çelësave kryhet në përputhje me Rregulloren mbi Administrimin dhe Përdorimin e Çelësave dhe Kodeve Numerikë në Bankën e Shqipërisë. Marrja/dorëzimi i çelësave dhe hapja/mbyllja e pajisjeve kryhet në prani të anëtarëve të caktuar të Komisionit të Administrimit të Fondit të Ekspozitës dhe dokumentohet me procesverbal.
3. Departamenti i Kërkimeve përcakton nivelin e fortësisë së ekspozitorit, në varësi të vlerave numizmatike që do të ekspozohen.

Neni 13

Kontrolli ditor dhe dokumentimi i parregullsive

1. Në fillim dhe në fund të çdo dite pune, një anëtar i Komisionit kryen kontroll vizual të vlerave dhe të integritetit të pajisjeve të ekspozimit.
2. Në rast dyshimi ose konstatimi të parregullsive/dëmtimeve/mungese:
 - a) njoftohet menjëherë Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes dhe Departamenti i Kërkimeve;
 - b) pezullohen vizitat;
 - c) mbahet procesverbali i konstatimit të dëmit, sipas udhëzimit "Për procedurat e nxjerrjes së akt-zhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë".

KREU IV EKSPOZITA TË VEÇANTA BRENDA BANKËS SË SHQIPËRISË

Neni 14 Organizimi i ekspozitave të veçanta

1. Përjashtimisht përcaktimeve të krerëve II dhe III të kësaj rregulloreje, për qëllime informuese, prezantuese ose promovionale, Banka e Shqipërisë organizon ekspozita të përkohshme me emetime përkujtimore në zonat e sigurisë së BSH-së.
2. Këto ekspozita ekspozojnë emetimet përkujtimore të Bankës së Shqipërisë me vlerë kontabël totale të ekspozimit deri në 50 mijë lekë dhe kopje për vlera mbi 50 mijë lekë.
3. Periudha e ekspozimit është deri në 6 muaj.
4. Emetimet përkujtimore për ekspozim merren nga fondi numizmatik i Muzeut dhe mbeten në ngarkim të të ngarkuarve me fondin numizmatik të Muzeut.
5. Përjashtimisht nga përcaktimet e nenit 6 të kësaj rregulloreje, organizimi i ekspozitave sipas pikës 1 të këtij neni kryhet me urdhër të veçantë të Drejtorit të Departamentit të Kërkimeve.
6. Këto ekspozita vendosen në zonat e sigurisë të Bankës së Shqipërisë, të monitoruara sipas përcaktimeve të nenit 11 të kësaj rregulloreje.
7. Emetimet përkujtimore ekspozohen në ekspozitorë të mbyllur, të tillë si kuti, korniza, instalacione etj., që pengojnë prekjen nga publiku.

KREU V EKSPOZITAT E PËRKOHSHME JASHTË BANKËS SË SHQIPËRISË (BRENDA TERRITORIT)

Neni 15 Grupi i Punës (GP)

1. Për çdo ekspozitë jashtë BSH-së, me urdhër të Administratorit përkatës, ngrihet GP-ja me përfaqësues nga:
 - a) Departamenti i Kërkimeve, njëri prej të cilëve në cilësinë e kryetarit të GP-së;
 - b) Departamenti i Administrimit, në cilësinë e anëtarit të GP-së;

- c) Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes, në cilësinë e anëtarit të GP-së.
2. Sipas nevojës, GP-ja mund të bashkëpunojë me ekspertë të jashtëm.
3. GP-ja përgatit programin e ekspozitës, konceptin kuratorial, planin e sigurisë, dokumentacionin kontraktual dhe të gjitha procesverbalet shoqëruese.

Neni 16

Kriteret e përzgjedhjes së fondit numizmatik të Muzeut për ekspozim

1. Për ekspozita jashtë BSH-së, mund të ekspozohen vetëm vlera të fondit numizmatik të Muzeut për të cilat institucioni disponon të paktën katër (4) copë për secilën prerje.
2. Përjashtime nga pika 1 e këtij neni bëhen vetëm në raste me rëndësi kombëtare, me kërkesë të institucioneve shtetërore dhe miratim paraprak të Këshillit Mbikëqyrës.
3. Në çdo rast vlerësohen: gjendja konservuese, rreziku i qarkullimit/transportit, dhe rëndësia kuratorialo-kulturore.

Neni 17

Marrëveshja me institucionin pritës

1. Me institucionin pritës për organizimin e ekspozitës lidhet kontratë/marrëveshje që përfshin minimalisht:
 - a) sipërfaqen ekspozuese;
 - b) kushtet e ambientit dhe monitorimin e tyre;
 - c) kushtet e ruajtjes fizike dhe elektronike (ruajtje 24/7, CCTV, sisteme kundër zjarrit dhe sinjalizim elektronik);
 - d) specifikimet teknike të pajisjeve ekspozuese, duke ruajtur standardet e ekspozitorëve të Muzeut të Bankës së Shqipërisë;
 - e) policën e sigurimit për objektet, me vlerë të përcaktuar nga BSH-ja;
 - f) përgjegjësitë për transportin, logjistikën, fotografimin/komunikimin publik;
 - g) procedurat e emergjencës dhe raportimit të incidenteve.
2. DSM-ja ndjek dhe verifikon zbatimin e kërkesave të sigurisë sipas kontratës dhe programit të miratuar.

Neni 18

Transporti dhe sigurimi

1. DSM-ja, në zbatim të marrëveshjes dypalëshe me Policinë e Shtetit dhe sipas protokolleve të BSH-së, organizon transportin, eskortën dhe magazinimin e përkohshëm.
2. Objektet mbulohen nga policia sigurimi (nga momenti i daljes nga Muzeu i Bankës së Shqipërisë deri në rikthim), në vlerën e deklaruar nga BSH-ja.
3. Paketimi dhe kutitë e transportit duhet të jenë të ambalazuara, sipas përcaktimeve të rregullores "Për veprimet me fondet në vlera monetare në Bankën e Shqipërisë". Hapja lejohet vetëm me autorizim dhe në prani të Komisionit.

Neni 19 Mbikëqyrja dhe raportimi

1. Një anëtar i Komisionit caktohet përgjegjës ekspozite në vend, dhe kryen kontrollin vizual të përditshëm të vlerave dhe të integritetit të pajisjeve të ekspozimit.
2. Çdo incident raportohet menjëherë te DSM-ja dhe kryetari i GP-së, sipas skemës së njoftimit të miratuar.

KREU VI EKSPOZITAT E PËRKOHSHME JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 20 Kërkesat shtesë ligjore dhe procedurale

1. Përveç kërkesave të Kreut IV të kësaj rregulloreje, për organizimin e ekspozitave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, zbatohen edhe përcaktimet e legjislacionit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë dhe aktet e tjera në fuqi për eksport të përkohshëm të veprave/objekteve.
2. Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes, në bashkëpunim me agjencitë ligjzbatuese, merr masat për transportin deri në pikën kufitare.
3. Departamenti i Administrimit zbaton kërkesat doganore e ato të sigurimit ndërkombëtar.
4. Kontrata me institucionin e huaj duhet të parashikojë specifikime të barazvlefshme ose më të larta sigurie dhe sigurim të pandërprerë të fondit të ekspozitës nga pika e nisjes, paketimit, ngarkim-shkarkimit, transportit, magazinimit të përkohshëm dhe ekspozimit, deri në kthim, sipas vlerës së përcaktuar nga BSH-ja.

KREU VII ZHDËNTIMI, PËRGJEGJËSITË DHE PASQYRIMI FINANCIAR

Neni 21 Zhdëntimi i vlerave të humbura ose të dëmtuara

1. Në rast humbjeje apo dëmtimi të fondit të ekspozitës dhe/ose pajisjeve të ekspozimit ndiqen procedurat disiplinore, civile dhe penale të parashikuara në aktet ligjore e rregullative të miratuara në fuqi.
2. Personi/at përgjegjës kryejnë zhdëntimin në masën të paktën dy herë më të lartë se vlera e tregut, e përcaktuar në momentin e zhdëntimit.
3. Në çdo rast, për vlerat numizmatike të listuara në katalogët ndërkombëtarë, vlera e tregut për qëllime zhdëntimi nuk do të jetë më e ulët se vlerësimi i bazuar në katalogët më të fundit ndërkombëtarë, publikime të "World Paper Money" dhe "World Coin News", sipas cilësisë më të lartë në katalog.

Neni 22 Përgjegjësitë e njërive

1. Departamenti i Kërkimeve është përgjegjës për kurimin, listën e objekteve që do të ekspozohen, dokumentimin muzeal dhe komunikimin kuratorial.
2. Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes është përgjegjës:
 - a) brenda ambienteve të Bankës së Shqipërisë kryen vlerësimin e rrezikut, përcakton programin e sigurisë, i cili miratohet nga Administratori përkatës;
 - b) për ekspozitat jashtë ambienteve të Bankës së Shqipërisë, por brenda Republikës së Shqipërisë, kryen veprimet në zbatim të Aktmarrëveshjes ndërmjet BSH-së dhe Ministrisë së Brendshme;
 - c) për aktivitete jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, jep vlerësimet dhe propozon protokollet konkrete të komunikimit dhe bashkëpunimit për çështjet e sigurisë me Ministrinë e Brendshme dhe vendin pritës.
3. Departamenti i Administrimit është përgjegjës për logjistikën e ambienteve dhe pajisjeve, marrëdhëniet me institucionin pritës për infrastrukturën.
4. Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës është përgjegjës për pasqyrimin financiar dhe kontabël të lëvizjeve dhe vlerave.

Neni 23 Regjistrimet dhe arkivimi

I gjithë dokumentacioni (vendimet e Këshillit Mbikëqyrës, urdhrat e Administratorëve, kontrata, procesverbalet, fotografitë) arkivohet sipas rregullave të Arkiv/Protokollit dhe mbahet edhe në format elektronik sipas standardeve të BSH-së.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Me hyrjen në fuqi të saj, shfuqizohet rregullorja "Për ekspozimin e vlerave numizmatike dhe administrimin e ruajtjen e tyre nga Banka e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr.40, datë 13.6.2012, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar.

Neni 25

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO

ANEKS 1 PROCESVERBAL

Dorëzim–marrje në dorëzim i Fondit të Ekspozitës

Nr.: _____ Data: _____ Vendi: _____

Baza ligjore/referenca:

Neni 9 i rregullores “Për organizimin e ekspozitave të përkohshme të vlerave numizmatike dhe objekteve muzeore të Bankës së Shqipërisë, brenda dhe jashtë Bankës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin (nr. _____, datë _____) dhe urdhri i Administratorit (nr. _____, datë _____) për ngritjen e Komisionit të Administrimit të Fondit të Ekspozitës.

Ekspozita: “ _____ ”

Periudha: _____ – _____

Vendi i ekspozimit: _____

Koleksioni	Vendndodhja	Kodi	Përshkrimi i artikullit	Sasia	Vl. Njësi	Vlera Totale

Dorëzues:

1. Emër Mbiemër, funksioni, njësi
2. Emër Mbiemër, funksioni, njësi
3. Emër Mbiemër, funksioni, njësi

Marrës në dorëzim:

1. Emër Mbiemër, funksioni, njësi
2. Emër Mbiemër, funksioni, njësi
3. Emër Mbiemër, funksioni, njësi

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 1, MARS 2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 3, datë 15.1.2025 për "Miratimin e Programit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri dhe dokumentacionit shoqërues"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 9, datë 5.2.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 10, datë 5.2.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare""
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 11, datë 5.2.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare""
5. Vendim i Zëvendës guvernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë, nr. prot. 1072, datë 4.3.2025 për "Miratimin e politikës së administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 14, datë 5.3.2025 "Për kryerjen e pagesës së rritjes së kuotës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 2, MAJ 2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 16, datë 26.3.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 17, datë 26.3.2025 "Për miratimin e "Pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2024""
3. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr. prot. 1456, datë 28.3.2025 "Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 20, datë 2.4.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Mbikëqyrjes""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 22, datë 2.4.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit""
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 24, datë 7.5.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 25, datë 7.5.2025 "Për vendosjen e kufijve të sipërm për treguesit "Raporti i kredisë ndaj vlerës" dhe "Raporti i shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave" për kredite që japin bankat për pasuri të paluajtshme rezidenciale"
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 26, datë 7.5.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor""
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 27, datë 7.5.2025 "Për rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, me prerje 2000 Lekë"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 3, GUSHT 2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.28, datë 4.6.2025 "Për miratimin e një ndryshimi në statutin e Bankës së Shqipërisë"
2. Vendim i Zëvendësguvernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë, nr.prot.2776, datë 16.6.2025 "Për shfuqizimin e licences së subjektit "NOA" sh.a. si institucion pagese"
3. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot.3015, datë 30.6.2025 "Për caktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.30, datë 2.7.2025 "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.31, datë 2.7.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.32, datë 2.7.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.33, datë 2.7.2025 "Për një ndryshim në rregulloren "Për mbikëqyrjen e konsoliduar"
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.35, datë 2.7.2025 "Për rishtypjen e monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor, prerja 100 Lekë"
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.37, datë 6.8.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.38, datë 6.8.2025 "Për dhënien e miratimit paraprak për licencimin e degës së bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania"
11. Vendim i Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, nr.prot.5988, datë 8.8.2025 "Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të shoqërisë së kursim-kreditit "Tirana Invest Kredit 2000" me shoqërinë e kursim-kreditit "Fushas Mumajes"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 4, SHTATOR 2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 42, datë 3.9.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrove të këmbimit valutor"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 43, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 5, SHTATOR 2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 44, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e sistemit AIPS Euro për shlyerjen e transfertave vendase për klientë në Euro"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.45, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH"